REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN

# REGJISTRI I KËRKESAVE-ANKESAVE VITI 2024

| Nr. Rendor (1) | Data e regjistrimit Kërkesës (2) | Objekti (3) *(Përmban ede përmbledhje të kërkesës)* | Data e kthimit të përgj. (4) *(Përmban edhe përmbledhjetë përgjigjes)* | Data e përgjigjes Kërkesës (5) | Statusi kërkesës (6) | Tarifa (7) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 09.01.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues A.B**<br><br>*Kërkohet se si të veprohet për të bë një kërkesë në Gjykatën e Apelit të rrethit Elbasan.*<br><br>*Për momentin disponohet një kopje e vendimit përfundimtar të dhënë në Mbretërinë e Bashkuar më datë 22 Shtator 2023 përkthyer edhe noterizuar nga një notere e qarkut Elbasan.* | **Përgjigje 1.**<br><br>Përshëndetje,<br><br>Gjykata e Elbasanit nuk është Gjykatë Apeli por Gjykatë e Shkallës së Parë me Juridiksion të Përgjithshëm.<br><br>Faleminderit<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | 10.01.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |
| 2 | 10.01. 2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues Klgj.**<br><br>*Përshëndetje të nderuar,* | **Përgjigje 2.**<br><br>E nderuar, | 12.01 .2024 | I plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *Uroj të jeni mirë.*<br>*Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është depozituar kërkesa për informacion nga Organizata S, në të cilën kërkohet vendosja në dispozicion e informacionit lidhur me numrin e padive gjyqësore me palë gazetarët ose punonjësit e medias për periudhën Janar 2023-Dhjetor 2023 si dhe stadin e shqyrtimit të tyre.*<br>*Për sa më sipër, në respektim të afateve të parashikuara në ligjin "Për të drejtën e Informimit", i ndryshuar, lutemi përcjelljen e informacionit të mësipërm nga gjykatat **brenda datës 15.01.2024***<br>*Bashkëlidhur e-mailit gjeni shkresën nr. .. prot., datë 04.01.2024 lidhur me kërkesën për informacion nga S.*<br>*Faleminderit.* | Shprehim konsideratën tonë për verpimtarinë tuaj!<br>Morëm dijeni për kërkesën e dërguar në postën elektronike në lidhje me shkresën nr. ... prot., datë 04.01.2024, të depozituar në Këshillin e Lartë Gjyqësor nga Organizata S.<br><br>Ju informojmë se nga kërkimet e kryera në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për periudhën Janar-Dhjetor 2023, rezulton një çështje e regjistruar me palë në proces gjyqësor gazetar, çështja është e regjistruar më datë 03.12.2023, me status në përpunim.<br><br>Për çdo paqartësi, jeni të mirëpritur të na kontaktoni.<br><br>Faleminderit<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | | | |
| 3 | 15.01.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues E.M**<br><br>*Jam E.M., kam aplikuar për sekretare gjyqësore pranë gjykatës tuaj, ku jam përzgjedhur për të dhëne provimin ë pranimit me shkrim.*<br>*A mund të më thoni a është catuar ndonjë datë për konkursin?*<br>*Jam në pritje të përgjigjes tuaj.* | **Përgjigje 3.**<br><br>Përshëndetje,<br><br>Informacionet ju komunikohen nga Kancelari Gjykatës në të dhënat e kontaktit që keni depozituar në aplikim.<br><br>Faleminderit<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | 15.01.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |
| 4 | 16.01.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues GJ.**<br><br>*Përshëndetje,* | **Përgjigje 4.**<br><br>Përshëndetje, | 18.01.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *Në cilësinë e familjarit (e bija) e z. N.GJ, të cilit i është vendosur masa e sigurisë arrest në burg me anë të Vendimit nr.901, datë 19.12.2023 nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.*<br>*Ankimimi kundër këtij vendimi është kryer më datë 05.01.2024.*<br>*Deri tani nuk kemi informacion nëse gjykata ka përcjellë ankimin dhe dokumentacionin përkatës pranë Gjykatës së Apelit sipas nenit 249 pika 3 e Kodit te Procedures Penale, e cila parashikon afatin 3 ditor, ndërkohë kanë kaluar 11 ditë. Duke ju falenderuar, lutemi në përcjelljen e një informacioni në një kohe sa më të shkurtër.*<br>*Bashkëlidhur do te gjeni mjetet indentifikuese dhe certifikatën familjare.* | Nga kontrolli i ushtruar rezulton se shtetasi N.GJ ka zgjedhur me të drejta të plota perfaqësimin e tij nga avokati G.R. Komunikimet e vendimeve gjyqësore dhe ankimet i komunikohen palëve dhe përfaqësuesve të tyre ligjorë të cilët rezultojnë të kenë marrë komunikim.<br><br>Faleminderit<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | | | |
| 5 | 18.01.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues E.M (MEDIA)**<br><br>*Përshëndetje Manjola!*<br>*E.M gazetarja e F.N s dhe I.W!*<br>*Infromacion për çështjen e të miturve.* | **Përgjigje 5.**<br><br>Përshëndetje Znj. D., faleminderit që iu përgjigjët kërkesës për identifikim.<br><br>Nga kërkimi në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, nuk rezulton planifikim seance për çështjen për të cilën shfaqni interes.<br><br>Faleminderit<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | 21.02.2023 | I plotë | Nuk ka tarifë |
| 6 | 19.01.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues A.S.**<br><br>*Kërkesë e librit të postës datë 19.01.2024 me objekt heqjen e të dhënave personale të fëmijës dhe anonimizimin e të dhënave të palëve në proces gjyqësor nga publikimi i shortit.* | **Përgjigje 6.**<br><br>E nderuar Znj. A.S.,<br><br>Në përgjigje të kërkesës tuaj të depozituar me datë 19.01.2024 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, ju bëjmë me dije se në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të Drejtën e Informimit", kërkesa për dhënie informacioni është regjisturar me Nr. 1466 në librin e postës, datë 19.01.2024, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. | 31.02.2023 | I plotë | Nuk ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Në zbatim të Ligj Nr.9887, datë 10.3.*2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" neni Neni 13/2 "E drejta për të kërkuar korrigjimin ose fshirjen ……2. Kontrolluesi, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës së subjektit të të dhënave, duhet ta informojë atë për përpunimin e ligjshëm të të dhënave, kryerjen ose moskryerjen e korrigjimit apo të fshirjes.'',* ju informojmë se pas shqyrtimit të kërkesës, nga të dhënat e gjenerauara nga Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, rezulton të jetë regjistruar më datë………çështje Civile Themeli, në të cilën Znj. A. S rezulton në cilësinë e paditësit.<br><br>Ju informojmë se çështjet gjyqësore, me paraqitjen në gjykatë, regjistrohen menjëherë në Sistemin Elektronik të Menaxhimit të Çështjeve (ICMIS) nga sekretaria gjyqësore, sipas kategorive të sistemit, nën mbikëqyrjen e kryesekretarit dhe kancelarit sipas të dhënave të kërkesë-padisë së paraqitur nga palët ose përfaqësuesit e tyre ligjorë.<br><br>Publikimi i "Informacion mbi Shortin" bëhet sipas Vendim Nr. 554, datë 29.12.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për Ndarjen me Short të Çështjeve Gjyqësore", ku pika III/7 përcakton: *"III. Procedurat dhe rregullat e ndarjes së çështjeve me short ……7. Raporti i shortimit është publik dhe pasqyrohet menjëherë në faqen zyrtare të internetit të gjykatës.".*<br><br>Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore ICMIS, është një sistem i integruar me faqen zyrtare të gjykatave https://gjykata.gov.al/, i cili realizon integrimin e të dhënave për çështjet e regjistruara në gjykatë. Informacionet e pasqyruara në short gjenerojnë të dhëna nëpërmjet një procesi automatik- elektronik duke pasqyruar te dhëna si: numri elektronik i çështjes, palët në proces gjyqësor sipas objektit të kërkesë-padisë, datën e regjistrimit të kërkesë padisë, relatorin e çështjes dhe objektin e kërkesë-padisë. Ky proces realizohet | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | mbi bazën e parimit të transparencës, informimit, kontrollit, mbikëqyrjes, gjurmimit, barazisë së shpërndarjes së çështjeve gjyqësore dhe objektivitetit për grupet e interesit.<br><br>Në këtë kuptim Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan,ka realizuar pasqyrimin e çështjes sipas procedurës në bazë të të dhënave të kërkesë-padisë së paraqitur në gjykatë. Nga të dhënat e gjenerauara nga Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, çështja me nr 2……. Civile Themeli, në të cilën Znj. A.S rezulton në cilësinë e paditësit është në përpunim sipas objektit të paraqitur në kërkesë-padi.<br><br>Referuar Udhëzimit Nr.15, datë 23.12.2011 "Për Përpunimin dhe Publikimin e të Dhënave Personale në Sistemin Gjyqësor" Kreu IV "Publikimi i Të Dhënave" pika 6 dhe 7. *"…Gjatë publikimit të vendimeve civile familjare, gjeneralitetet e palëve ndërgjygjëse paraqiten me iniciale ose kodohen, ndërsa ndalohet publikimi i rrethanave që cenojnë dinjitetin dhe jetën private të tyre ose personave të tjerë të lidhur me çështjen gjyqësore, si dhe i të dhënave, mbi dhënien e mendimit të fëmijës, mbi detyrimin ushqimor, mbi takimet e të miturit me prindërit, kohën dhe vendin e takimit, mbi raportin e psikologut, etj. 7. Në të gjitha rastet kur palët në gjykim janë minorenë, ndalohet publikimi i gjeneraliteteve dhe të dhënave të tjera identifikuese (personale) ose të dhënave lidhur me të tretë, nga të cilat mund të zbulohet edhe indirekt, identiteti i minorenit."*, ju informojmë se gjykata pas vendimmarrjes për një çështje gjyqësore, gjatë procesit të publikimit të vendimit realizon gjithashtu procesin e anonimizimit të të dhënave personale dhe sensitive të vendimeve gjyqësore."<br><br>Faleminderit<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 7 | 23.01.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues media M.V.**<br><br>*Përshëndetje,*<br><br>*Kërkesë për vendosjen në dispozicion të vendimeve gjyqësore për shtetasin D.H* | **Përgjigje 7.**<br><br>Përshëndetje z. V,<br><br>Në përgjigje të kërkesës tuaj, ju informojmë se nga kërkimi ushtruar në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, nuk rezultojnë çështje për shtetasin **D.H.**<br><br>Nëse dispononi të dhëna të tjera lutemi t`i përcillni.<br><br>Faleminderit<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | 23.01.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |
| 8 | 23.01.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues media M.V.**<br><br>*Manjola Ju falenderoj për shpejtësinë e përgjigjes.*<br><br>*Kërkesa që ju cova bazohet në këtë komunikatë të policisë ku thuhet se ndaj D.H. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan i ka caktuar masën e sigurisë "Arrest në burg", për veprat penale "Vrasja me paramendim" dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve luftarake dhe municionit".*<br><br>*Prandaj ju drejtova kërkesën tuaj.*<br>*Nuk e di nëse kjo e dhëne ju ndihmon ne identifikimin e vendim qoftë edhe për masë sigurie.*<br><br>*Faleminderit*<br><br>*(Komunikata bashkëlidhur)* | **Përgjigje 8.**<br><br>Përshëndetje Z. V,<br><br>Me të dhënat e deleguara në e-mailin pararendës, arkivistja e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, ushtroi kontrollin për Masat e Sigurimit për periudhën e cituar në kërkesë datë **….2009** dhe nga kontrolli ushtruar nuk rezulton "Masë Sigurimi" për shtetasin **D.H.**<br><br>Faleminderit<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | 25.01.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 9 | 24.01.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues**<br><br>*Përshëndetje.*<br><br>*Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 78, datë 21.09.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"", janë forcuar edhe më tej rregullat, mekanizmat dhe procedurat për njohjen me informacion/dokumentacion me karakter publik nga qytetarët.*<br><br>*Bazuar në pikën 2 të nenit 24/1 të ligjit të sipërcituar "Autoritetet publike raportojnë çdo vit, jo më vonë se data 31 e muajit janar të vitit pasardhës, pranë Komisionerit lidhur me veprimtarinë për zbatimin e kërkesave të këtij ligji, sipas formatit të miratuar nga Komisioneri."*<br><br>*Për sa më sipër, ju lutem plotësoni pyetësorin e mëposhtëm brenda datës **31.01.2024** duke klikuar tek ky link:*<br><br>-<br>*https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSctZ_YFde8iumV_-Xs8VkyX1Cfri9xxxe8b1E73M8Vg6WDGdA/viewform?usp=sf_link*<br><br>*Për sa i përket pyetësorit, ai është në format Google Drive dhe për të aksesuar duhet të keni një llogari në gmail. Nëse nuk e keni të mundur plotësimin e formularit online në google form, mund të plotësoni tabelën në excel të cilën e gjeni bashkëlidhur. Formati në excel përmban të njëjtat pyetje që janë shënuar në pyetësor.*<br><br>*Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,*<br><br>*Gjithë të mirat,*<br><br>*Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale* | **Përgjigje 9.**<br><br>Përshëndetje të nderuar,<br><br>Bashkëlidhur gjenden raportimet e regjistrit të kërkesave të raportuara në lidhjen si në vijim:<br><br>https://gjykata.gov.al/rrethi-elbasan/gjykata-e-shkall%c3%abs-s%c3%ab-par%c3%ab-e-juridiksionit-t%c3%ab-pergjithsh%c3%abm-elbasan/programi-i-transparences/njoftime-te-tjera/<br><br>Për shkak të përditësimit të regjistrit të kërkesave sipas formatit të referuar nga Komisioneri në të cilën duhet të referohen pyetjet/përgjigjet në regjistrin e kërkesave, si edhe ju kemi venë në dijeni jemi duke përditësuar sistemin në përshtatje me programin e tranparencës.<br><br>Regjistri për vitin 2023 e në vijim do të hidhet në sistem sapo të përfundojë përditësimi i programit të transparencës në ditët në vijim, regjistër i cili nuk do të përfshijë kërkesat për vendime, kërkesat për seanca gjyqësore, kërkesat për shtyrje seancash gjyqësore, kërkesat drejtuar gjyqtarëve etj për shkak shkak se përgjigjet për këto kërkesa janë standarte dhe përfshijnë të dhëna sensitive per palët në proces gjyqësor.<br><br>Ju informojmë se programi i transparencës është përfunduar dhe miratuar. Po punohet me përditësimin e rubrikave të programit nga zyra e IT.<br><br>Pas përfundimit të procesit të hedhjes së të dhënave në program sipas rubrikave përkatëse do tiu njoftojmë sërisht në vijim nëpërmjet e-mail.<br><br>Faleminderit për bashkëpunim<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan | 31.01.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | | | |
| 10 | 26.01.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues H.M.**<br><br>*Përshëndetje.*<br><br>*Jam H.M, kam pasur një proces gjygji për divorc, në datën 11.12.2023, dhe ka mbaruar procesi, dmth jam ndarë, ju lutem sa vonohet shpallja ose letra për në gjëndje civile, ju lutem pasi duhet të jem i divorcuar.* | **Përgjigje 10.**<br><br>Përshëndetje,<br><br>Vendimet e arsyetaura i komunikohen palëve sipas procedurës, një kopje vendimi ikomunikohet edhe gjëndjes cilvile. Aktualish cështja me palë H.M rezulton në përpunim.<br><br>Faleminderit<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | 29.01.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |
| 11 | 28.01.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues A.XH.**<br><br>*Përshëndetje, uroj që email im t`iu gjejë mirë.*<br>*Emri im eshte A.XH.*<br>*Bashkangjitur ndodhet edhe karta ime e identitetit .*<br>*Duke qenë se do doja të aplikoja për pension pleqërie, më kërkohet një dokument nga gjykata për njohje vjetërsie pune.*<br>*Ajo që unë nuk di është sesi e marr këtë vendim gjykate, ku duhet të drejtohem për te aplikuar për këtë vendim?*<br>*Jam ne pritje të përgjigjes tuaj.*<br>*Paraprakisht faleminderit. A. Xh.* | **Përgjigje 11.**<br><br>Përshëndetje,<br><br>Duhet t`i drëjtoheni gjykatës me kërkesë-padi për njohje të viteve te punës. Për asistencë të metejshme në përpilimin e kërkesë-padisë konsultohuni me avokat. Nëse jeni subjekt i ligjit Nr. 111/2017 "Për ndihmën Juridike të garantuar nga shteti", mund të paraqiteni pranë Qendrës së ndihmës Juridike Parësore në katin e parë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan në zyrën e e Ndihmës Juridike Falas Elbasan.<br><br>Faleminderit<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | 29.01.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 12 | 31.01.2024 | ***Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues A.K.***<br><br>*Përshëndetje!*<br><br>*Uroj të jeni mirë!*<br>*Quhem A.K i biri i ….. i datëlindjes … , me nr Id……, me nr kontakti 06…… ,*<br>*Në cilësinë e zëdhënëses për marrëdhënien me median dhe publikun të Gjykatës së Elbasanit po ju shpreh ankesën time si më poshtë :*<br><br>*Kam marrë nga zyra e Arshivës këtë vendim prej 18 faqesh me nr vendimi… datë 20.11.2018 dhe pasi e kam përkthyer dhe noterizuar ja kam nisur zyrës së aplikimit për bashkim familjar në Florida USA. Edhe pse e kam nisur dy herë nga zyra e pranimit të dokumentave më kërkohet një vendim i shkurtuar me gjysëm faqe A 4 të firmosur nga titullari i Gjykatës dhe nga nga Kancelari i Gjykatës, edhe pse jam paraqitur pranë zyrës së arshivës dhe Kancelarit më është refuzuar mundësia e marrjes së një vendimi të tillë me një faqe. Ju lutem të më ktheni një përgjigje të argumentuar nga gjykata t`ia u vë në dispozicion zyrës së pranimit të dokumentave në Florida USA për këtë pamundësi të dhënies se vendimit të shkurtuar me një faqe sikurse e kërkon kjo zyrë.*<br><br>*Po ju vë në dispozicion faqen e parë të vendimit si dhe kthimin e përgjigjes nga zyra e pranimit të dokumntave në Florida USA.*<br>*Po ju dërgoj edhe të Skanuar Vendimin për të cilin kërkoj shkurtim.*<br>*Ngelem me shpresë të më ktheni një përgjigje ju lutem të nderuar.* | **Përgjigje 12.**<br><br>Përshëndetje,<br><br>Shkurtim i vendimi bëhet vetëm nga gjyqtari që ka gjykuar dhe ka dalë me vendim për një çështje. Shkurtimi i vendimit bëhet nga gjyqtari i çështjes dhe jepet me miratim të gjyqtarit të çështjes i firmosur prej tij.<br><br>Çështja për të cilën kërkoni "shkurtim vendimi" i përket gjyqtarit T.T i cili nuk ushtron më funksionin si gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.<br><br>Në këto rrethana është e pamundur të jepet nga gjykata dokumentacioni i kërkuar me objekt “Shkurtim Vendimi”.<br><br>Faleminderit<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | 01.02.2024 | | |
| 13 | 01.02.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues M.M.**<br><br>*Një kërkesë tjetër është lidhur me numrin e urdhër mbrojtjeve të lëshuara nga gjykata për dhunën në familje tek grate e tek meshkujt.Dhe për këtë nese eshte e mundur nje sinkron.*<br>*M.M* | **Përgjigje 13.**<br><br>Përshëndetje,<br><br>Në përgjigje të kërkesës tuaj në lidhje me kërkesat me objekt “Lejim Martese” nga viti 2019 deri në Janar 2024 nga kontrolli ushtruar në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan nuk rezultojnë regjstrime sipas këtij objekti.<br><br>Faleminderit | 02.08.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | | | |
| 14 | 08.02.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues media M.R.**<br><br>*Përshëndetje,*<br><br>*Sa është numri i çështjeve në të cilat Gjykata e Elbasanit ka lejuar martesën e një shtetasi të mitur, nën moshën 18 vjeç, në zbatim të nenit 7 të Kodit të Familjes, gjatë viteve 2017-2023? Sa prej tyre janë meshkuj dhe sa janë femra? M.R*<br><br>*Faleminderit znj. Kume, për përgjigjen.*<br><br>*Ju lutem, mund të kem të dhëna edhe për dy vitet e tjera të përfshira në kërkesë 2017 dhe 2018?*<br><br>*Faleminderit dhe punë të mbarë.*<br>*M.* | **Përgjigje 14.**<br><br>Përshëndetje,<br><br>Në përgjigje të kërkesës tuaj në lidhje me kërkesat me objekt "Lejim Martese" nga viti 2019 deri në Janar 2024 nga kontrolli ushtruar në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan nuk rezultojnë regjstrime sipas këtij objekti.<br><br>Në lidhje me kërkesat me objekt "Lejim Martese" për vitet 2017- 2018 nga kontrolli ushtruar në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan rezulton një regjstrim kërkese me objekt "Lejim Martese".<br><br>Faleminderit<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | 08.02.2024 | | |
| 15 | 05.02.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues**<br><br>*Manjola ju përshendes duke iu uruar një jave të mbarë.*<br>*Në vijim të komunikimit tonë javën e shkuar kam mundur të gjej detajet e vendimit për të cilin interesohem.*<br><br>*Ato janë:*<br><br>***Nr 2….. (6……………………-13) Regj Them Date Regj …………..2024.***<br>***Nr. 2………. (13-………….) Vendim date vendimi 12.01.2024.*** | **Përgjigje 15.**<br><br>Përshëndetje i nderuar Z. V,<br><br>Duke shprehur konsideratën tonë për veprimtarinë tuaj, në përgjigje të kërkesës tuaj të dërguar në postën elektronike të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasanmë datë 05.02.2024, me objekt "Kërkese për Vendime Gjyqësore", ju bëjmë me dije se në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të Drejtën e Informimit", kërkesa për | 08.02.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *Faleminderit* | dhënie informacioni është shqyrtuar dhe pas kontrollit të ushtruar në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, në lidhje me vendimet e kërkuara ju informojmë se:<br>1. Vendimi **Nr 2…(6……………..13) Regj Them Date Regj ……2024,** është vendim me objekt kërkese "Masë Sigurimi" , kërkues Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Kërkesë në Fazën e Hetimit Paraprak me bazë ligjore "Material i Mbyllur". Dosja për këtë çështje është ende nën hetim në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Në këto kushte për shkak të detyrimit ligjor që rrjedh nga Neni 279/3/b. i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë : "Detyrimi për të Ruajtur Sekretin Hetimor" i cili përcakton në pikën **3.b "Ndalimin e publikimit të përmbajtjes së akteve të veçanta apo të dhënave të posaçme që lidhen me veprime hetimore të caktuara",** nuk mund të dërgojmë kopje të anonimizuar të këtij vendimi.<br>2. Në lidhje me vendimin e dytë Nr. 2..(13…..) Vendim datë vendimi ………2024, nga kontrolli ushtruar në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, nuk rezultojnë të dhëna sipas përcaktimeve të dërguara.<br><br>Faleminderit që na kontaktuat.<br>Ju urojmë punë të mbarë<br>Me konisderatë | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | | | |
| 16 | 05.02.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues A.B Media.**<br><br>*Në bazë të ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kërkoj informacion për çështjet e mëposhtme: Në datë 14.12.2023 kam marrë një përgjigje nga ana juaj pas një kërkese për informacion. Objekt i kësaj kërkese ishin të dhënat statistikore lidhur me procedime penale në bazë të nenin 202/a për tregtimin e specieve të rralla. Sipas përgjigjes së dhënë nga ana juaj rezulton se nuk ka pasur raste që janë referuar, hetuar apo dërguar për gjykim. Por pak ditë pas përgjigjes nga ana juaj, më është vënë në dispozicion një përgjigje nga Prokurorisë Tiranë e cila deklaron si vijon: "Procedimi penal nr.4….. i vitit 2…., për veprat penale "Dëmtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër" dhe "Tregtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër", parashikuar nga nenet 202 dhe 202/a të Kodit Penal. Më datë 19….. është dërguar shpallur moskompetenca lëndore dhe dosja është dërguar për hetime të mëtejshme në Prokurorinë e Elbasanit". Referuar kësaj përgjigje, ku sqarohet se ky procedim është përcjellë tek ju për hetime, kërkoj detaje lidhur me këtë referim, se si është proceduar më tej; A janë mbyllur hetimet? Sa persona janë nën hetim? Dhe çdo detaj tjetër që nuk ndikon në sekretin hetimor.*<br><br>*A.B MEDIA* | **Përgjigje 16.**<br><br>*Përshëndetje,*<br><br>1. *Kërkesa juaj e datës 07.12.2024 është me objekt kërkese si më poshtë:*<br><br>Gjatë vitit 2023, a ka pasur referime nga Prokuroria për veprën penale të sanksionuar në nenin 202/a të Kodin Penal "Tregtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër (Shtuar me ligjin nr. 44/2019, datë 18.7.2019) Tregtimi i ekzemplarëve të specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër ose pjesëve apo nën produkteve të tyre, duke shkelur kërkesat e legjislacionit nëfuqi për mbrojtjen e faunës së egër dhe për zonat e mbrojtura apo të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë ka ndodhur mbi një sasi të papërfillshme të këtyre ekzemplarëve dhe ka ndikim të papërfillshëm mbi statusin e ruajtjes<br>së specieve, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet." Nëse po, në çfarë faze është gjykimi? 2. Po gjatë viteve 2022, 2021, 2020, 2019 a ka pasur referime për këtë vepër penale, cili është fati i këtyre referime? 3. A janë dhënë dënime në 5 vitet e fundit për këtë vepër penale?Shënim: Informacionet që do të më vihen në dispozicion të jenë sa më të detajuara të mundshme dhe<br>të ndarë sipas viteve.<br><br>*Referuar kësaj kërkese përgjigja dhënë është plotësisht e saktë referuar bazës ligjore të përcaktuar në kërkesë:*<br><br>Elbasan, më 14.12.2023 | 09.02.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Lënda: Statistika për veprën penale të sanksionuar në nenin 202/a të Kodit Penal "Tregtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër" Kërkuesit: Z. A.B<br><br>Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, në postën elektronike manjola.kume@gjykata.gov.al. në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën për dhënie informacioni, të rregjistruar më datë 07/12/2023. Pas shqyrtimit të kërkesës, ju informojmë se: 1- Nga kontrolli ushtruar në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ne regjistrin elektronik për vitin 2023, nuk rezultojnë regjistrime me objekt bazë ligjore Neni 202/a i Kodit Penal "Tregtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër " . 2- Nga kontrolli ushtruar në regjistrat e statistikave të publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për vitet 2018-2022, nuk rezultojnë regjistrime me objekt bazë ligjore Neni 202/a të Kodit Penal "Tregtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër". Regjistrat e statistikave të çështjeve gjyqësore për vitet 2018-2022 janë informacion publik të cilët i gjeni të publikuar në faqen zyrtare të www.gjykataelbasan.gov.al .<br><br>*Ju është referuar gjithashtu që statistikat gjenden sipas bazës ligjore dhe publikohen në faqen zyrtare pasiqë janë informacion publik dhe nëse bëni kërkimin në statistikat do t`iu rezultojë e njëjta përgjigje për nenin 202/a të kodit penal.*<br><br>2. *Në kërkesën tuaj të dytë më datë 05.02.2024 ju informojmë se nuk rezultojnë të dhëna sipas këtij Nr. Procedimi nr.4…. i vitit 2……* | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | *Referohuni statistikave të publikuara në faqen zyrtare në lidhjen si në vijim ku mund të gjeni statistikat nga viti 2018-2022 për çështje penale dhe civile.*<br><br>*https://gjykata.gov.al/rrethi-elbasan/gjykata-e-shkall%C3%ABs-s%C3%AB-par%C3%AB-e-juridiksionit-t%C3%AB-pergjithsh%C3%ABm-elbasan/gjykata/rreth-gjykat%C3%ABs/*<br><br>Faleminderit<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | | | |
| 17 | 07.02.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues media G.A.**<br><br>*Përshëndetje!*<br><br>*Uroj te jeni mirë, emisioni "S", kohë më parë ka publikuar rastin e vjedhjes se një sasi të konsiderueshme cigaresh në Polis të Elbasanit.*<br><br>*Tani çështja është referuar nga Prokuroria Elbasan në Gjykatën e Elbasanit në gjyq.*<br>*Sipas të dhenave procesi gjyqësor fillimisht është gjykuar nga gjyqtarja znj. M. S. ku për shkak të lejes së lindjes i ka kaluar një tjetër gjyqtari z. A.P.*<br>*Kërkojmë information se kur do të caktohet seanca e rradhës nga gjyqtari, pasi na rezulton që ka kaluar një kohë e konsiderueshme pa u caktuar një datë për këtë gjykim.*<br><br>*Faleminderit* | **Përgjigje 17.**<br><br>Përshëndetje i nderuar Z. A,<br><br>Duke shprehur konsideratën tonë për veprimtarinë tuaj, në përgjigje të kërkesës tuaj të dërguar në postën elektronike të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasanmë datë 07.02.2024, me objekt "Kërkese për informacion", ju bëjmë me dije se në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të Drejtën e Informimit", kërkesa për dhënie informacioni është shqyrtuar dhe pas kontrollit të ushtruar në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, ju informojmë se për çështjen për të cilën kërkoni informacion me palë në proces gjyqesor shtetasit L.K., dhe I.B., më datë 16.01.2024 me vendim në dhomë këshillimi është caktuar seance gjyqësore më datë …………2024 ora ………., çështje për të cilën gjykata është në proces njofttimesh për palët.<br><br>Faleminderit që na kontaktuat.<br>Ju urojmë punë të mbarë | 09.02.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Me konisderatë<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | | | |
| 18 | 12.02.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues E.D.,**<br><br>*Përshëndetje znj.Manjola! Më duhet një informacion i shkurtër mbi numrin e divorceve gjatë vitit 2023 në Elbasan.*<br><br>*Pa dashur tju ngarkoj se me duhet për një live sot.*<br>*E.D. gazetare, mjetet e identifikimit jua kam dërguat më herët.*<br><br>*Faleminderit!* | **Përgjigje 18.**<br><br>Përshëndetje,<br><br>Referuar statistikave të vitit 2023 për kërkesat me objekt "Zgjidhje Martese" rezultojnë:<br><br>• 588 kërkesa të mbartuara nga 3 mujori fundit i vitit 2022<br>• 591 kërkesa të ardhura të reja për vitin 2023<br>• 335 kërkesa janë pranuar<br>• 4 kërkesa janë refuzuar<br>• 108 kërkesa janë pushuar<br>• 447 kërkesa janë përfunduar<br><br>Faleminderit<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | 12.02.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |
| 19 | 13.02.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues**<br><br>*Përshëndetje jam H.M., ju lutem nëse mundeni të bëni diçka me shpejtë për të dorzuar letrën e divorcit në gjendjen civile ju lutem. Do më ndihmonit shumë , pasi dua të divorcohem ta mbylle kete ceshtje dhe te filloje jeten, ju lutem pasi kaluan dy muaj nga gjygji fundit . ju lutem, faleminderit* | **Përgjigje 19.**<br><br>Përshëndetje,<br><br>Vendimet gjyqësore komunikohen sipas procedurës nga gjykata.<br><br>Faleminderit<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median | 13.02.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | | | |
| 20 | 12.02.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues K.M.**<br><br>*Nga ana e Zyra përmbarimore A.B., shpk, përmbaruesi gjyqësor privat A.B., kryhen veprime përmbarimore për një procedurë përmbarimore me palë kreditore BANKA……’, me debitor K.M., dhe debitore garantor kredie shoqërinë tregetare O. shpk, K. M., e M. M., Së fundmi përmbaruesi gjyqësor ka urdhëruar shitjen në ankand të pasurive të paluajtshme në pronësi të K.M., e M.M., konkretisht të pasurive : = “are” me sipërfaqe ……. m2 Zk….., nr.pasurie ………., lagje … , …….. , = pasurine e llojit truall + ndertese, me siperfaqe totale …… nga te cilat ……. ndertese, zk ……., pasuri me nr. …….., ne lagjen ……… . Përmbaruesi më ka berë me dije se ka urdhëruar që njoftimi për ankand do të shpallet në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan (gjykata e vendit ku ndodhet pasuria), sipas nenit 568 te K.P.Civile. Sa më sipër kërkoj informacion për sa më poshtë : 1.A ju ka sjellë Zyra përmbarimore A.B., shpk, përmbaruesi gjyqë sor privat A.B., shkresë apo shpallje për ankand? Bëhet fjalë për periudhën janar-shkurt 2024. 2.Nëse ju ka sjellë të tillë shpallje, në cilën datë ju ka ardhur, a e keni publikuar, nga cila datë ka nisur publikimi dhe afishimi , dhe deri në cilën datë ka qëndruar e afishuar kjo shpallje? 3. Lutem më jepni kopje të njësuar me origjinalin të kësaj shpallje. Lutem me jepni përgjigje sa më parë sepse brenda afatit ligjor duhet të ngre padi gjyqësore për të kundërshtuar veprimet përmbarimore. Këtë kërkesë po jua dërgoj edhe në rrugë elektronike në emailin e publikuar ne faqen zyrtare të gjykatës. Jam i gatshëm të paraqitem menjëherë për të marrë përgjigjen dhe aktet e kërkuara me sipër, kundrejt pagesës, ndaj lutem të më njoftoni sa më parë në numrin telefonik 06…….. Bashkëlidhur edhe karta eidentifikimit. Elbasan datë 12.2.2024.* | **Përgjigje 20.**<br><br>Përshëndetje i nderuar z.M.,<br><br>Në përgjigje të kërkesës tuaj të dërguar në postën elektronike të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan më datë 13.02.2024, me objekt “Kërkese për informacion”, dhe kërkesës me të njëjtin objekt të deozituar në Zyrën e Arkivës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, ju bëjmë me dije se në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, “Për të Drejtën e Informimit”, për dhënie informacioni është shqyrtuar, kërkesa është regjistruar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me Nr. 294 Prot., më datë 13.02.2024.<br><br>Nga kontrolli ushtruar rezulton se:<br><br>Përmbaruesi Gjyqësor Privat A.B., ka depozituar nëpërmjet postës shkresën me Nr. .....Prot., të datës 22.01.2024, e cila është dorëzuar nëpërmjet postës së datës 24.01.2024, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan e regjistruar me Nr. ....Prot.,;<br><br>Shpalljet për Afishim Publik nga Përmbaruesit Gjyqësor Privat publikohen në faqen zyrtare të gjykatës në rubrikën “Njoftime të Tjera”;<br>Kjo shpallje është afishuar në datë ........ në faqen zyrtare të Gjykatës në lidhjen si në vijim https://gjykata.gov.al/rrethi-elbasan/gjykata-e-shkall%C3%ABs-s%C3%AB-par%C3%AB-e-juridiksionit-t%C3%AB-pergjithsh%C3%ABm-elbasan/njoftime-t%C3%AB-tjera/, në rubrikën Njoftime të Tjera me titull “LAJMËRIM | 13.02.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | PËRMES AFISHIMIT PËRMBARUES ADMIR BEQIRI NR …. PROT me përshkrimin NJOFTIM ME SHPALLJE PUBLIKE DEBITORIT ……..”.<br><br>Bahkëlidhur kësaj shkrese gjendet:<br><br>Kopje e Lajmërimit të Përmbaruesit Gjyqësor A.B., me Nr. ... Prot., depozituar më datë ....., publikuar më datë ......;<br><br>Foto e faqes zyrtare të gjykatës e cila referon datën e shpalljes së Lajmërimit të Përmbaruesit Gjyqësor A.B., me Nr. ..... Prot., më datë .......<br><br>Duke ju falenderuar, shprehim gashishmërinë tonë për çdo paqartësi.<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | | | |
| 21 | 14.02.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues G.G.**<br><br>*Lutem të na kthehet një përgjigje me shkrim/email e menjëhershme kërkesës urgjente të mëposhtme nga përmbaruesi G.G., i zyrës përmbarimore Elbasan dhe jo vetëm (institucionet e përmendura në këtë email) në adresat elektronike : ………….. dhe ………. . Kërkoj në mënyrë urgjente nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Jurudiksionit ë Përgjithshëm Elbasan referuar vendimit 1…. datë ….. te gjykatës Elbasan , me gjyqtare Z.V., i cili mori formë të prerë më date 14.12.2021 pasi në Gjykatën e Apelit Durrës në atë datë me vendimin nr. 10-……… është vendosur lënie në fuqi e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan të vendimit të lartëpërmendur, të më konfirmoj kur ky vendim i është dërguar zyrës së gjendjes civile, Bashkia Elbasan . Nga komunikimi avokates time M.B., në telefon me numër 003556……..me përmbaruesin e Elbasanit G.G., rezulton sipas përmbaruesit që dosja është dorëzuar për ekzekutim nga avokat G.K., më datë ……2024 , nuk eshtë ndryshuar në gjendjen civile , ……adresa e ish bashkëshortes time, znj.B.S., dhe rezulton ende me gabim , në adresën e ish bashkëshortit D.SH., në ……………. Kërkoj një kopje të skanuar dhe origjinale të vendimit të* | **Përgjigje 21.**<br><br>Përshëndetje!<br>Komunikimi i vendimeve u bëhet palëve në proces gjyqësor dhe përfaqësuesëve të tyre ligjorë, siaps procedurës që ndjek gjykata .<br><br>Për t`u njohur dhe pajisur me aktet e dosjes së vendim Nr 1…. datë ….., lutemi të paraqiteni në Zyrën e Arkivës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, e cila u vendos në dijeni për kërkesën tuaj. Në dosje gjenden aktet dhe komunikimet për çështjen.<br><br>Faleminderit<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | 14.02.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *lartpërmendur me pullë nga arshiva gjithashtu t`i jepet ky vendim në dorëzim znj. M.B., kundrejt pagesës. Në të kundërt Zyra e Gjendjes Civile , …….. të bëj korrigjimin urgjent të adresës së znj.B.S., sipas adresës në vendimin gjyqësor të divorcit të formës së prerë, në ………nga …………… (një kërkesë e tillë mundet të bëhet prej zyrës së përmbarimit Elbasan) për rrjedhoje dosja përmbarimore nuk ka nevojë të transferohet në zyrën përmbarimore shtetërore Lushnje me kërkesë të avokatit G.K., (me prokurë datë 16.04.2022 me notere E.C.), i cili ende nuk ka dorëzuar një kerkese te tille per transferim ne zyren permbarimore Lushnje nga zyra përmbarimore Elbasan. Kërkoj informacion nga gjykata Elbasan se kurështeë depozituar kërkesa për lëshim autorizimi (për lëvizje të fëmijes tim ë mitur F.SH jashte shtetit, Greqi) me kërkues mua D.F., përfaqësuar me prokurë të posacme nga avokat G.K., dhe gjyqtar A.K., më thoni kur do të zbardhet vendimi i kësaj çështje, i cili eshte marr më datë ....., më dërgoni të skanuar një kopje origjinale dhe dy kopje origjinale të vendimit për lëshim autorizimi (për levizje të fëmijës F.SH jashte shtetit,Greqi) t`i jepen në dorezim kundrejt pagesës znj. M.B..Kush ka qenë gjyqtari i parë dhe kur e ka marr cështjen në dorë gjyqtari A.K.<br>Në pritje të përgjigjes tuaj urgjente .<br>Whats up : 00355….<br>Duke iu falenderuar ,* | | | | |
| 22 | 08.02.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues V.K.**<br><br>*Të nderuar, Unë V.K.,, gazetar pranë B, në bazë të ligjit nr. 119 dt. 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit", neni 3 dhe Udhëzuesit Standard të Marrëdhënieve të Gjykatave me Publikun dhe Median, nenet 11 dhe 12 kërkoj të kem akses në dosjet penale me palë të pandehur shtetasin turk F.Ö., Vendimet e gjykatës mbi shtetasin F.Ö. . Mbetemi në pritje të përgjigjes tuaj. Përgjigja dhe dokumentet mund të dërgohen me postë elektronike në adresën ……., , po ashtu Ju lutem më njoftoni mbi kohën kur dosja mund të aksesohet pranë gjykatës. Kjo kërkesë bazohet në ligjin e sipërpërmendur, i cili shprehet: "Kërkuesit i vihet në dispozicion një kopje e plotë e dokumentit zyrtar, për të cilin kërkon të informohet." Duke u bazuar në ligjin nr 119, "Për të drejtën e informimit" këto informacione vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë specifike dhe të arsyetuar". Për çdo komunikim tjetër me qëllim orientimin dhe sqarimin e paqartësive, mund të më kontaktoni edhe në në kontaktet e mëposhtme. Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, V.K., Gazetar Tel: +3556………email: ……………..* | **Përgjigje 22.**<br><br>Përshëndetje i nderuar z. K.,<br><br>Duke shprehur konsideratën tonë për veprimtarinë tuaj, në përgjigje të kërkesës tuaj të dërguar në postën elektronike të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasanmë datë 08.02.2024, me objekt "Kërkese për kopje aktesh nga dosja për shtetasin F.O", ju bëjmë me dije se në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të Drejtën e Informimit", kërkesa për dhënie informacioni është shqyrtuar dhe pas kontrollit të ushtruar, kërkesa u përcoll në Kryesekretarinë e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, ku ndodhet dosja për të cilën shprehni interes. | 12.02.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Për shkak se dosja është voluminoze duhet të paraqiteni në Arkivën e Kryesekretarisë e cila ndodhet në katin e parë të gjykatës për t`u njohur me aktet që ju nevojiten.<br><br>Faleminderit që na kontaktuat.<br>Ju urojmë punë të mbarë<br>Me konisderatë<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | | | |
| 23 | 16.02.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues G.C.**<br><br>*Kërkoj të informohem me shkrim në lidhje çështjen time të divorcit me palë ndërgjyqëse G.C., dhe R.C., sepse nuk jam informuar nga avokati im I.G.. Nuk e di si ka përfunduar gjyqi ne Elbasan cfarë është vendosur atje dhe përse është ankimuar dhe kur është ankimuar . Kërkoj një kopje të njësuar të dosjes time në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe* ***përse është vonuar data e gjykimit*** *. Kërkoj me urgjencë një kopje të skanuar te dosjes time gjyqësore ditën e sotme dhe një kopje të njësuar me origjinalin e cila do teë merret në dorëzim nga znj. M.B.*<br>*Cili është gjyqtari sipas shortit që i ka rënë cështja ime dhe data e gjyqit gjithashtu të më caktohet një datë urgjente e përshpejtuar referuar nenit 460 të Kodit të Procedurës Civile sepse çështja ime familjare është tejet e rëndë dhe sensitive dhe kërkon një vëmendje të vecantë (janë tre fëmijë të mitur që babai i rrit vetëm pasi nëna e tyre i ka braktisur) .*<br>*Bashkëlidhur gjeni leternjoftimin elektronik të G.C., me numer personal ………. e numer 03……. lindur më ……. ne Elbasan dhe pasaportën e M.B., .*<br>*Telefon : 00355………………;* | **Përgjigje 23.**<br><br>Përshëndetje!<br><br>Komunikimi i vendimeve u bëhet palëve në proces gjyqësor dhe përfaqësuesëve të tyre ligjorë, sipas procedurës që ndjek gjykata.<br><br>Nga kontrolli ushtruar në Kryesekretarinë e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, dosja me palë në proces gjyqësor G.C., dhe R.C. gjendet në Gjykatën e Apelit.<br><br>Në dosjen gjyqësore gjenden aktet dhe komunikimet për çështjen.<br><br>Faleminderit<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | 16.02.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |
| 24 | 07.03.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues I.M.**<br><br>*Përshendetje* | **Përgjigje 24.**<br><br>Përshëndetje e nderuar, | 25.03.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *Unë I.M., kam qenë paditëse në procesin gjyqesor: I.M. - kundër EKB Elbasan etj. me objekt njohje pronësie.*<br><br>*Çështje e gjykuar nga I.M.*<br><br>*Më date 18.01.2024, nëpërmjet këtij emaili kam kërkuar transkriptin e seancës gjyësore të qershorit 2022.*<br><br>*Por rezulton sot me datë 07.03.2024 se nuk kam asnjë përgjigje nga gjykata juaj!*<br><br>*Prandaj kërkojë, brenda datës 11.03.2024, të më vendoset në dispozicion me urgjence transkriptimi ose kopje e CD të seancës së qershor 2022.* | Kërkesat tuaja përcillen në sekretaritë gjyqësore në datën e mbëritjes së kërkesës(nëse janë kërkesa të ardhura në orarin zyrtar), ose të nesërmen e dërgimit të kërkesës nësë është dërguar jashtë orarit zyrtar me korrespondencë elektronike.<br><br>Pas delegimit të kërkesës, sekretaria gjyqësore ju informon në lidhje me përgjigjen kur dosja është ende në proces gjyqësor.<br><br>Nga kontrolli ushtruar kërkesa juaj për transkritp e datës 17.01.2024 është deleguar në sekretarinë gjyqësore të dosjes në date 18.01.2024, për këtë keni marrë konfirmim delegimi nga korrespondenca e datës 24.01.2024.<br><br>Kërkesa juaj e datës 07.03.2024 është dërguar në sekretarinë gjyqësore më datë 11.03.2024 për shkak se nga data 07.03.2024 deri më datë 13.03.2024 nëpunësi për marrëdhëniet me publikun dhe median ka qenë me leje të zakonshme (por njoftimet në sekretari gjyqësore janë përcjellë në kohë.)<br>Për këtë keni patur një kthim përgjigje më datë 12.03.2024.<br><br>Nga kontrolli ushtruar rezulton se keni tërhequr kopjen e CD më datë 18.03.2024 nga personi i tretë R.T..<br><br>Faleminderit<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | | | |
| 25 | 13.03.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues KLGJ.**<br><br>*“Verifikim Ankese” me Nr. ……. Prot., të datës 13.03.2024.* | **Përgjigje 25.**<br><br>Përshëndetje të nderuar,<br><br>Duke shprehur konsideratën tonë për veprimtarinë tuaj, në përgjigje të kërkesës tuaj me objekt “Verifikim Ankese” me Nr. ……. Prot., të dates 13.03.2024, të depozituar me datë 18.06.2024 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, ju bëjmë me dije se në përputhje me | 27.03.2024 | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të Drejtën e Informimit", kërkesa për dhënie informacioni është regjisturar me Nr. … Prot., datë 18.03.2024, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.<br><br>Për kërkesat e dërguara nga znj. I.M, ka patur korrespondecë të rregullt elektronike të delegimi të kërkesave në sekretarinë gjyqësore të çështjes dhe znj. I.M., është informuar për delegimin e çdo kërkese të saj në sekretarinë gjyqësore.<br><br>Nga kontrolli ushtruar rezulton se më datë 18.03.2024, është paraqitur dhe ka tërhequr kopje CD i biri z. R.T.<br><br>Bashkëlidhur gjendet:<br>1- Kopje e konfirmimit të marrjes së CD- së nga i biri R.T. 2 (dy) fletë;<br>2- Korrespondenca e kërkesave nga Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median. 10 (dhjetë) fletë<br><br><br>Me konsideratë,<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al<br><br><br>*Njoftim për ankesën dhe znj. I. M., nëpërmjet postës elektronike. Dt. 27.03.2024.*<br><br>Përshëndetje e nderuar,<br><br>Bashkëlidhur përgjgje e ankesës 602/1, dërguar Këshillit të Lartë Gjyqësor për kërkuesen znj. I.M.<br><br>Kjo përgjigje ju dërgohet sipas adresës së kontaktit të lënë në ankesën tuaj.<br><br>Faleminderit<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| | 26 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues I.SH.**<br><br>*Përshëndetje,*<br><br>*Në referencë të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", lutemi më nevojitet një informacion si më poshtë vijon (për arsye të një punimi akademik):*<br><br>***-Sa ka qenë numri i çështjeve penale të rregjistruara që lidhen me veprën penale të parashikuar në nenin 290 të Kodit Penal "Shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor" për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023?***<br><br>***-Sa prej këtyre cështjeve kanë përfunduar dhe sa janë akoma në proces ?***<br><br>*Nëse informacionin e dispononi në formë tabelash apo grafiku (evidenca statistikore) lutemi të na e dërgoni në atë formë.*<br><br>*Duke Ju falenderuar paraprakisht, mbetem ne pritje të një përgjigje brenda afateve ligjore. Bashkengjitur ID.*<br><br>*Punë të mbarë,*<br><br>***I.SH***<br>***Kandidate për gjyqtare***<br>***Shkolla e Magjistratures***<br>***Viti Akademik 2023-2024*** | **Përgjigje 26.**<br>Wed 3/27/2024 10:27 AM<br><br>Përshëndetje,<br><br>Fillimisht ju urojmë suksese në punën tuaj, të dhënat statistikore publikohen në faqen Web të gjykatës si më poshtë. https://gjykata.gov.al/rrethi-elbasan/gjykata-e-shkall%C3%ABs-s%C3%AB-par%C3%AB-e-juridiksionit-t%C3%AB-pergjithsh%C3%ABm-elbasan/gjykata/rreth-gjykat%C3%ABs/<br><br>Për lehtësi, do tìu nis një përpunim të materialit sipas objektit të kërkesës tuaj pasi të më dërgohet saktësimi i të dhënave të kërkuara në zyrën e statistikave.<br><br>Me konsideratë,<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al<br><br>Thu 3/28/2024 12:58 PM<br>Përshëndetje e nderuar,<br><br>Duke shprehur konsideratën tonë për veprimtarinë tuaj, në përgjigje të kërkesës tuaj të dërguar në postën elektronike të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan më datë 15.03.2023, me objekt "**Sa ka qenë numri i çështjeve penale të rregjistruara që lidhen me veprën penale të parashikuar në nenin 290 të Kodit Penal "Shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor" për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023?-Sa prej këtyre cështjeve kanë përfunduar dhe sa janë akoma në proces** ", ju bëjmë me dije se në përputhje me nenin 11 të | 27-28.03.2024 | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Ligjit nr.119/2014, "Për të Drejtën e Informimit", kërkesa për dhënie informacioni është shqyrtuar dhe pas kontrollit të ushtruar të dhënat statistikore të publikuara në faqen e gjykatës https://gjykata.gov.al/rrethi-elbasan/gjykata-e-shkall%C3%ABs-s%C3%AB-par%C3%AB-e-juridiksionit-t%C3%AB-pergjithsh%C3%ABm-elbasan/gjykata/rreth-gjykat%C3%ABs/ në indeksin "Statistikat 2023", në formularin "çështje penale" rezulton se për nenin 290 të dhënat janë të grupuara në fraksionet 290/2,3,4, nga ku rezulon se 10 çështje janë të mbartura nga viti 2022, 17 çështje të ardhura të reja për vitin 2023, totali i çështjeve për vitin 2023 është 27 dhe janë përfunduar 26 prej tyre, të kanë vendimmarrje fajësie.<br><br>Faleminderit që na kontaktuat.<br>Ju urojmë punë të mbarë<br>Me konisderatë<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | | | |
| 27 | 20.03.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues D.SH.**<br><br>***URGJENTE***<br><br>*Znj.Manjola Kume kërkojmë menjëherë vendimin e zbardhur, vendimin gjyqesor me pulle dhe dosjen gjyqësore të njësuar të çështjes që ka gjykuar gjyqtar A.K., me objekt lëshim autorizimi për të lëviz jashtë i mituri F.SH. Do të paraqitet znj.P.B., menjëherë tani për ti marr në dorëzim (bashkelidhur gjeni karten e identitetit te saj) meqenese deri me sot nuk ka ardh asnje informacion me postë zyrtare në adresën e deklaruar në vendim dhe ne adresen e dytë të dhënë prej meje së fundmi : Rr……… , kati …, Ap. ….. Tirane ; telefon : 003556… qofte dhe me email e skanuar apo shkurtimi vendimit të skanuar paraprakisht dhe nuk e dimë arsyen se përse është neglizhuar duke qene se situata ishte emergjente , djalit te mitur i eshte shkaktuar nje stres shume i madh per keto vonesa sepse kerkon te takoj babain e tij . Lutem të me konfirmohet marrja e emailit e respektohet urgjenca e ndjeshmëria sidomos kur behet fjale per çështje delikate ku në mes është një fëmijë i mitur që ndjen mungesën e babait të tij dhe nuk mundet ta përballoj mallin. Na i dergoni gjithashtu të skanuara paralelisht sepse sapo jam informuar që vendimi lartpërmendur rezulton* | **Përgjigje 27.**<br><br>Përshëndetje të nderuar,<br><br>Ju informoj që kam qenë në periudhë leje të zakonshme për disa ditë, por arkiva është njoftuar për kërkesën tuaj për t`u njohur me dosjen.<br><br>Kërkesat për kopje aktesh të dosjes siç edhe kemi njoftuar shpesh av. M.B, paraqiten në arkivë, pas pagesës së shpenzimeve gjyqësore mund të tërhiqen kopjet e tyre.<br><br>Ju vendosim në dispozicion përgjigjen e datës 15.02.2024.<br><br>*To:………………..*<br>*Thu 2/15/2024 12:19 PM*<br>*Përshëndetje!* | 21.03.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *i zbardhur. Afati 10 ditor i kthim pergjigjes ka perfunduar nga emaili i heres se fundit qe iu kemi derguar(pa pergjigje) prej jush. .* | *Komunikimi i vendimeve u bëhet palëve në proces gjyqësor dhe përfaqësuesëve të tyre ligjorë, siapas procedurës që ndjek gjykata .*<br><br>*Për t`u njohur dhe pajisur me aktet e dosjes së vendim Nr 1…….datë 12.11.2019, lutemi të paraqiteni në Zyrën e Arkivës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, e cila u vendos në dijeni për kërkesën tuaj. Në dosje gjenden aktet dhe komunikimet për çështjen.*<br><br>*Faleminderit*<br><br>Në lidhje me vendimin e zbardhur të gjykatës me gjyqtar A.K., njoftohem nga Kryesekretaria që vendimi iu është komunikuar palëve sipas procedurës dhe e keni tërhequr edhe në Kryesekretarinë e Gjykatës.<br><br>Në lidhje me vendimin nr. 1…, nga zyra e Arkivës më informojnë se Av. M.B., është paraqitur personalisht për t`u njohur me aktet e dosjes dhe ka tërhequr vendimin pasi është njohur edhe me dosjen.<br><br>Nëse keni paqartësi mund të paraqiteni sërisht në zyrën e Arkivës për t`u njohur sërisht me dosjen në çdo kohë.<br><br>Arkiva është vënë në dijeni për kërkesë tuaj.<br><br>Faleminderit<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | | | |
| 28 | 17.04.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues media B.K.**<br><br>*Përshëndetje!* | **Përgjigje 28.**<br><br>Përshëndetje, | 18.04.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *Kam nevojë të di kur mbahet masa e sigurisë për rastin e përdhunimit në Mengël. Një prej autoreve të dyshuar R.B.*<br><br>*Faleminderit* | Seanca e kërkesës në fazën e hetimit paraprak për personat e ndaluar B. J. dhe R.B., do të zhvillohet në datë ………… në orën …………..<br><br>Faleminderit<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | | | |
| 29 | 24.04.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues media M.V.**<br><br>*Në vijim të interesimit tim dhe përgjigjes tuaj në 25 Mars, desha të di nëse për tre çështjet në shqyrtim në gjykatën tuaj për njohje vendimi a është marrë ndonjë vendim apo jo.*<br>*Ju falenderoj në advance per ndihmen tuaj duke ju uruar një ditë të mbarë.* | **Përgjigje 29.**<br><br>Përshëndetje i nderuar,<br><br>Pas shqyrtimit të kërkesës tuaj, nga verifikimi i kyrer në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, ju informojmë se kërkesat vijojnë me status në përpunim.<br><br>Faleminderit<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | 24.04.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |
| 30 | 29.04.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues B.K.**<br><br>*Përsh . pse nuk ka short që nga dt 19 flm* | **Përgjigje 30.**<br><br>Përshëndetje nuk rezulton të ketë probleme,<br><br>* Informacionin mbi shortin e gjeni të afishuar në lidhjen si më poshtë duke ndjekur hapat si në vijim:<br>1. Aksesoni në lidhjen si më poshtë:<br>https://gjykata.gov.al/rrethi-elbasan/gjykata-e-shkall%C3%ABs-s%C3%AB-par%C3%AB-e-juridiksionit-t%C3%AB-pergjithsh%C3%ABm-elbasan/informacion-mbi-shortin/<br>2. Ndryshoni periudhën sipas rendit: Muaji (pa vendosur nr. zero)/Data/Viti për periudhën për të cilën keni interes.<br>3. Më pas klikoni në ikonën "View Report" | 02.05.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 4. Më pas klikoni në ikonën "Save" për të ruajtur informacionin e kërkuar.<br>* Nëse hasni vështirësi për "Informacion mbi Shortin" mund të na shkruani në adresën zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan duke bashkëlidhur në çdo rast në kërkesë:<br>- Mjet identifikimi të palës në proces gjyqësor<br>- Prokurë përfaqësimi të palës në proces gjyqësor+ mjet<br>Identifikimi<br><br>Faleminderit<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | | | |
| 31 | 30.04.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues S.XH.**<br><br>*Përshëndetje,*<br><br>*jam S.Xh.*<br>*Doja informacione ku mund të mar vendimin e gjykatës për divorcin e bërë nV tetor 2019 pasi më kërkohet në vendin ku un jetoj në Itali.*<br>*Këtë dokument mund ta kërkoj një familiar i imi apo mund të ma dërgoni me postë,faleminderit.* | **Përgjigje 31.**<br><br>Përshëndetje,<br><br>Mund të paraqiteni në çdo kohë ju si palë ose përfaqësuesi ligjor me prokurë për të tërhequr vendimin me vulë të njomë për tarifat do të informoheni nga nëpunësi arkivës në momentin e aplikimit.<br><br>Faleminderit<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | 30.04.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |
| 32 | 02.05.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues S.K.**<br><br>*Përshëndetje Znj. Manjola Kume!*<br><br>*Në përmbushje të bazës ligjore të sipërcituara do doja që brenda mundësive që keni të më vinit të në dispozicion.* | **Përgjigje 32.**<br><br>Përshëndetje i nderuar z. S.K,<br><br>Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan), në | 03.05.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *Vendimet penale urdhër mbrotje apo vendime civile të dhëna për periudhën 2015–2024. D.F.; S.J.; I.O.;*<br><br>*Me urgjencë nëse do e merrni në konsideratë kam periudhën 2023-2024.*<br><br>*Për çdo komunikim tjetër me qëlllim orientimin dhe sqarimin e paqartësive , mund të më kontaktoni edhe në :*<br><br>*Tel: 069………*<br><br>*Duke mbetur në pritje të një përgjigje të shpejtë dhe pozitive nga ana juaj. Ju falenderoj për mirëkuptimin.* | përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën për dhënie informacioni më datë 02.05.2024 në postën elekronike.<br><br>Ju informojmë se kërkesat për informacion nga mediat duhet të kenë bashkëlidhur:<br><br>• Mjetin e identifikimit (i cili gjendet në kërkesën tuaj)<br>• Kartën e medias të cilën përfaqësoni ( e cila mungon)<br>•<br><br>Me vendim të datës 06.12.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi "Udhëzuesin Standard të Marrëdhënieve të Gjykatave me Publikun dhe Median", në të cilën gjendet "Deklarata Konfidencialitetetit" të cilën po e dërgojmë bashkëlidhur këtij komunikimi për plotësim, pas plotësimit të saj lutemi të ridërgohet bashkëlidhur kërkesës.<br>.<br>Ju informojmë se kërkesa juaj është në përpunim dhe po punohet për evidentimin dhe anonimizimin e vendimeve të kërkuara.<br><br>Me konsideratë,<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al<br><br>-------------------------------------------------------------<br>**Përgjigje 32/1 (IDENTIFIKUAR 09.05.2024)**<br>**Përgjigje 09.5.2024**<br><br>Përshëndetje i nderuar z. S.K. dhe faleminderit që iu përgjigjët kërkesës për identifikim! | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ---------------------------------------------------------------------------------<br>**Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues S.K. 32/1/1** | Duke shprehur konsideratën tonë për veprimtarinë tuaj, në përgjigje të kërkesës tuaj të dërguar në postën elektronike të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan më datë 02.05.2024, me objekt "Kërkesë për Vendime Gjyqësore", ju bëjmë me dije se në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të Drejtën e Informimit", kërkesa për dhënie informacioni është shqyrtuar dhe pas kontrollit të ushtruar në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, dhe në Zyrën e Arkivës në lidhje me vendimet e kërkuara ju informojmë se për periudhën e kërkuar nga ju, vitet **2015-2024,** rezultojnë këto të dhëna:<br><br>• Për shtetasen D. F., rezulton vendim gjyqësor për kërkesën civile me objekt "Lëshim urdhër mbrojtje' i cili gjendet bashkëlidhur;<br>• Për shtetasin S. J., nuk rezultojnë të dhëna për vendime gjyqësore në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, dhe në Zyrën e Arkivës;<br>• Për shtetasin I. O., rezulton vendim për kërkesën penale me objekt "Ulje dënimi" i cili gjendet bashkëlidhur.<br><br>***Ju rikujtojmë se përpunimi dhe mbrojtja e të dhënave personale është detyrim ligjor në zbatim të Ligj nr.9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".***<br><br>Me konisderatë<br>------------------------------------------------------------<br>**Përgjigje 32/1/2**<br>**Përgjigje 10.05.2024** | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Dt.09.05.2024**<br><br>*Pershendetje sërish znj. Manjola Kume!*<br><br>*Faleminderit për kthimin e përgjigjes!*<br><br>*A është e mundur të kem vendimin penal nr….. datë … të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ku shtetasi I.O., është dënuar përfundimisht me 6 vjet burgim për veprën penale të parashikuar nga neni 114/ a të Kodit Penal.*<br><br>*Apo më duhet të bëj një kerkesë të re?*<br><br>*Me respekt*<br><br>*S* | Përshëndetje,<br><br>Kërkesa u mor në shqyrtim. Sapo të jetë gati vendimi anonimizuar iua dergojmë.<br><br>Faleminderit<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al<br><br>------------------------------------------------------------<br>**Përgjigje 32/1/3**<br>**Përgjigje 13.05.2024**<br>Përshëndetje i nderuar z. S.K<br><br>Bashkëlidhur iu dërgojmë vendimin e anonimizuar.<br><br>• ***Ju rikujtojmë se përpunimi dhe mbrojtja e të dhënave personale është detyrim ligjor në zbatim të Ligj nr.9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".***<br>• ***Ju infomojmë gjithashtu se për shkak të përfshirjes në ngjarje shtetas të mitur në zbatim të Ligj Nr. 37/2017 "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur", neni 21/2/4 përcakton: "2. Nuk publikohet asnjë informacion që mund të çojë në identifikimin e të miturit në konflikt me ligjin, të të miturit viktimë ose dëshmitar i një vepre penale. 4. Ndalohet identifikimi ose publikimi në çfarëdolloj forme i të dhënave personale të të miturit".***<br><br>Me konisderatë<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | | | |
| 33 | 03.05.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues E.F.**<br><br>*Përshëndetje*<br><br>*Kërkoj informacion mbi një vendim gjyqi për divorc, pasi kanë kaluar afatet e ankimimit dhe ende nuk është dërguar në Gjendjen Civile B..*<br>*Divorci me palë paditëse E.F.*<br><br>*Faleminderit* | **Përgjigje 33.**<br><br>Përshëndetje,<br><br>Nga kontrolli ushtruar në Kryesekretari vendimi me palë në proces gjyqësor E.F. dhe marrë formë të prerë në datë 26.04.2024 dhe është dërguar në gjëndjen civile më datë 29.04.2024<br><br>Faleminderit<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | 03.05.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |
| 34 | 15.05.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues Sh.p.k.**<br><br>*Përshëndetje!*<br>*Shoqëria " sh.p.k ka hartuar kërkesë padinë për depozitim pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me palë dhe objekt:*<br>*Objekti: Përmbushje detyrimi në vlerën ………. lekë*<br><br>*Me qëllim pagimin e tarifës gjyqësore të kësaj padie konform nenit 156 te K.Pr.Civile, lutemi të na dergohet një fature me e-mail për taksën e padisë, në menyre që të na krijohet mundësia në cilesinë e palës paditëse për pagesën përpara depozitimit të padisë në Gjykatë!*<br>*Bashkëlidhur gjeni kërkesë padinë me të dhënat sipër cituar. Shoqëria "" sh.p.k qëndron në dispozicion për cdo informacion tjetër të nevojshëm!*<br><br>*Duke ju falenderuar!* | **Përgjigje 34.**<br><br>Përshëndetje,<br><br>ju informojmë se për plotësimin e faturës: "Tarifë gjyqësore për kërkesë padi standarte ose 1% mbi vlerën e saj", mund të ndiqni këto hapa:<br>1- Klikoni në lidhjen si më poshtë vijon<br>https://gjykata.gov.al/.../gjykata/rreth-gjykat%C3%ABs/<br>2- Klikoni butonin poshtë informacionit si më poshtë vijon:<br>Tarifë gjyqësore për kërkesë padi standarte ose 1% mbi vlerën e saj.<br>4. Pasi të shkarkoni faturën e mandat-pagesës, e cila gjenerohet në "formatin exel", ku janë implementuar formulat përkatëse për gjenerimin automatik të vlerave të pagesës pas plotësimit të të dhënave të kërkesë-padisë:<br>• kodi institucionit është i përcaktuar në mandat;<br>• kodi i degës së thesarit ku vepron është i përcaktuar në mandat;<br>• kodi i llogarisë ekonomike do të plotësohet automatikisht pasi të keni vendosur në kuadratët e përcaktuar si më poshtë të dhënat sipas kërkesë padisë: | 15.05.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | •Vendos shumën për të cilën do paguhet taksa;<br>•Vendos numri i palëve në kërkesë padi.<br>Pas plotësimit të vlerave të kërkesë- padisë, do t'iu gjenerohen automatikisht vlerat e faturave që duhet të paguani.<br>5. Pasi të keni plotësuar dhe printuar mandat-pagesën, mund të paraqiteni në çdo bankë të nivelit të dytë për të kryer pagesën.<br>6. Më pas, një kopje e mandat-pagesës të tërhqur në bankën ku keni kryer veprimet, vendoset bashkëlidhur më kërkesë-padinë dhe dërgohet nëpërmjet postës në adresë të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan e cila është: Lagjja "5 Maji", Rruga "Koço Brisku", Elbasan, Shqipëri.<br>Faleminderit<br>*Ky mandat-pagese, është i vlefshëm për vlera të kërkesë-padisë mbi 300.000 ALL, nën këto vlera dhe për çdo pagesë tjetër të tarifave gjyqësore të afishuara në lidhjen si në vijim: https://gjykata.gov.al/.../informa.../tarifa-gjyq%C3%ABsore/ , duhet të paraqiteni në arkën e Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan kati i parë për kryerjen e pagesave me mandat-arkëtimi.<br><br>Faleminderit<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | | | |
| 35 | 10.05.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues l.Ç.**<br><br>*Pershendetje.*<br><br>*Unë jam L.Ç, Gazetare e O., dhe uroj të gëzoni shëndet të mirë.*<br>*Do ju lutesha të kem bashkëpunimin tuaj në lidhje me një çështje të cilën ne mendojme se ka interes publikimi.*<br>*Në dokumentin atach, po ju dërgojme kërkesën tonë ku janë përmbledhur çështjet për të cilat lusim në bashkëpunimin tuaj.*<br>*Me respekt*<br><br>*Kërkesa bashkëlidhur me objekt:* | **Përgjigje 35.**<br><br>Përshëndetje e nderuar znj. L.Ç,<br><br>Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan), në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën për dhënie informacioni më datë 10.05.2024 në postën elekronike.<br><br>Ju informojmë se kërkesat për informacion nga mediat duhet të kenë bashkëlidhur: | 13.--21.05.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *Vënie në dispozicion dokumentet/informacionet zyrtare në lidhje me: Operacionet policore të koduara: T1; T2; T3 të cilat sipas informacioneve që disponoj kanë sjellë nisjen e procedimeve penale – së paku – ndaj personave në vijim:*<br><br>*Më konkretisht:*<br><br>*1- Kopje të kërkesave për vlerësimin e masave të sigurisë kërkuar nga DVP dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Elbasan, për periudhën Shtator 2023-Maj 2024 në kuadër të Operacioneve Policore "T" për të dyshuarit e listuar më sipër – por dhe të tjerëve të përfshirë në grup me to, apo të proceduar ngjashëm si ata, – për veprat penale: "Kultivimi i bimëve narkotike", parashikuar nga Neni 284; 284/1; "Prodhim dhe shitja e lëndëve narkotike", parashikuar nga Neni 283/1; 283/2; "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve/armëve shpërthyese dhe i municionit", parashikuar nga Neni 278.*<br><br>*2- Kopje të vendimeve për masat e sigurisë kërkuar nga DVP dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Elbasan, për periudhën Shtator 2023-Maj 2024 në kuadër të Operacioneve Policore "T" për të dyshuarit e listuar më sipër – por dhe të tjerëve të përfshirë në grup me to, apo të proceduar ngjashëm si ata, – për veprat penale: "Kultivimi i bimëve narkotike", parashikuar nga Neni 284; 284/1; "Prodhim dhe shitja e lëndëve narkotike", parashikuar nga Neni 283/1; 283/2; "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve/armëve shpërthyese dhe i municionit", parashikuar nga Neni 278.*<br><br>*3- Kopje të vendimeve për pushim të hetimeve kërkuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Elbasan, për periudhën Shtator 2023-Maj 2024 në kuadër të Operacioneve Policore "T" për të dyshuarit e listuar më sipër – por dhe të tjerëve të përfshirë në grup me to, apo të proceduar ngjashëm si ata, – për veprat penale: "Kultivimi i bimëve narkotike", parashikuar nga Neni 284; 284/1; "Prodhim dhe shitja e lëndëve narkotike", parashikuar nga Neni 283/1; 283/2; "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve/armëve shpërthyese dhe i municionit", parashikuar nga Neni 278.*<br><br>*4- Kopje të kërkesave për gjykim kërkuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Elbasan, për periudhën Shtator* | • Mjetin e identifikimit (i cili gjendet në kërkesën tuaj)<br>• Kartën e medias të cilën përfaqësoni (e cila mungon)<br>•<br>Me vendim të datës 06.12.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi "Udhëzuesin Standard të Marrëdhënieve të Gjykatave me Publikun dhe Median", në të cilën gjendet "Deklarata Konfidencialitetetit" të cilën po e dërgojmë bashkëlidhur këtij komunikimi për plotësim, pas plotësimit të saj lutemi të ridërgohet bashkëlidhur kërkesës.<br><br>Me konsideratë,<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al<br><br>-------------------------------------------------<br><br>Wed 5/15/2024 11:44 AM<br>Përshëndetje sërisht,<br><br>Ju informojmë se kërkesat për informacion nga media duhet të kenë bashkëlidhur kartën e institucionit që përfaqësoni dhe deklarata e konfindencialitetit duhet të nënshkuhet manualisht dhe të dërgohet në format të skanuar. Këto kritere janë zbatuar për çdo kërkesë të mbërritur nga media.<br><br>Përsa i përket kërkesës tuaj ju informojmë se çështjet gjyqësore, me paraqitjen në gjykatë, regjistrohen menjëherë në Sistemin Elektronik të Menaxhimit të Çështjeve (ICMIS) nga sekretaria gjyqësore, sipas kategorive dhe evidentimi i tyre gjatë ushtrimit të kontrollit nuk gjerneron të dhëna nëpërmjet emrit të koduar të operacionit të Prokurorisë apo | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *2023-Maj 2024 në kuadër të Operacioneve Policore "T" për të dyshuarit e listuar më sipër – por dhe të tjerëve të përfshirë në grup me to, apo të proceduar ngjashëm si ata, – për veprat penale: "Kultivimi i bimëve narkotike", parashikuar nga Neni 284; 284/1; "Prodhim dhe shitja e lëndëve narkotike", parashikuar nga Neni 283/1; 283/2; "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve/armëve shpërthyese dhe i municionit", parashikuar nga Neni 278.*<br><br>*5- Kopje të vendimeve për proceset e nisura nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Elbasan, për periudhën Shtator 2023-Maj 2024 në kuadër të Operacioneve Policore "T" për të dyshuarit e listuar më sipër – por dhe të tjerëve të përfshirë në grup me to, apo të proceduar ngjashëm si ata, – për veprat penale: "Kultivimi i bimëve narkotike", parashikuar nga Neni 284; 284/1; "Prodhim dhe shitja e lëndëve narkotike", parashikuar nga Neni 283/1; 283/2; "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve/armëve shpërthyese dhe i municionit", parashikuar nga Neni 278.*<br><br>*Duke ju falënderuar paraprakisht për bashkëpunimin, mbetem në pritje të përgjigjes tuaj! Për çdo komunikim tjetër me qëllim orientimin dhe sqarimin e paqartësive, mund të më kontaktoni edhe në: …………..*<br>*--------------------------------------------------------------------------------E nderuar z. Manjola. Ju faleminderit për saktësimet e kërkuara nga ana juaj, por duke qenë se deri më tani nuk e kam hasur këtë praktikë pune nga insitucionet e ngjashme, nuk ju kam dërguar dokumentet shtesë që ju kërkoni.*<br><br>*Gjithesesi ne dokumentet bashkëngjitur, ju keni Deklaratën e nënshkruar të Konfidencialitetit dhe ID time. Sa i përket kartës së gazetarit, unë mendoj se ju e keni atë në koken zyrtare të kërkesës që iu është dërguar.*<br>*Po kështu keni të gjitha të dhënat e Organizatës, dhe numrin personal të drejtuesit të saj.*<br>*Shpresoj që të dhënat e përcjellura të jenë shteruese për ju, në mënyrë që të vijojmë bashkëpunimin në dhënien e informacionit të kërkuar nga ana jonë.*<br>*Faleminderit dhe punë të mbarë.*<br><br>*--------------------------------------------------------------------------------*<br><br>*Përshëndetje!* | Policisë, por në bazë të kërkesës së prokurorisë sipas numrave të procedimit. Ju lutem përcaktoni të dhënat saktë në mënyrë që të evidentojmë çështjet.<br><br>Me konsideratë,<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al<br><br>------------------------------------------------------------<br>Tue 5/21/2024 1:43 PM<br>Përshëndetje e nderuar,<br><br>Në zbatim të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", pas shqyrtimit të kërkesës tuaj ju informojmë se:<br>1. Në kuadër të trasparencës në faqen zyrtare të gjykatës në lidhjen si në vijim janë përcaktuar kushtet e dhënies së informacionit me kërkesë në lidhjen si në vijim: | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *Kërkesa është bërë me amail dhe automatikisht dhe firmosja elekotronike njihet nga ligji. Së dyti, ju po kërkoni informacione që nuk janë brenda ligjit të së drejtes së informamimit sa i përket kontratës personale që unë kam me Organizatën..*<br><br>*Unë nuk po detyroj dhënien e informacionit, refuzojeni atë dhe bashkë shihemi tek Komisioneri për të drejtën e informamimit, por mos kërkoni të dhëna që nuk i përcakton ligji.*<br>*Punë të mbarë.* | https://gjykata.gov.al/rrethi-elbasan/gjykata-e-shkall%C3%ABs-s%C3%AB-par%C3%AB-e-juridiksionit-t%C3%AB-pergjithsh%C3%ABm-elbasan/na-kontaktoni/<br><br>Bazuar në:<br><br>• Ligj nr.119/2014"Për të Drejtën e Informimit";<br>• Ligj Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" "Për të Drejtën e Informimit";<br>• Vendim Nr. 716, datë 06.12.2023 "Udhëzues Standard të Marrëdhënieve të Gjykatave me Publikun dhe Median".<br>2. Gjykata për dhënien e kopjeve të vendimeve gjyqësore nga hyrja në fuqi e tij bazohet në Vendim Nr. 716, datë 06.12.2023 "Udhëzues Standard të Marrëdhënieve të Gjykatave me Publikun dhe Median" KAPITULLI III AKSESI NË VENDIMET GJYQËSORE DHE TË DHËNAT E TJERA TË GJYKATËS.<br>a. "*Neni 12. Aksesi në dosjet gjyqësore. Dosjet gjyqësore aksesohen në çdo kohë nga palët në proces, përfaqësuesit ligjorë të tyre, gjyqtari apo trupa gjykuese e çështjes, prokurori/ët i/e çështjes, si dhe çdo person ose institucion publik tjetër i autorizuar sipas ligjit. 2. Si rregull, personave të interesuar për përdorimin e vendimeve gjyqësore për qëllime studimore, shkencore,statistikore, literature apo gazetarie, i vihet në dispozicion vetëm kopja e vendimit të plotë, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.* | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | *Përjashtim bëjnë rastet kur në përgjigje të një kërkese të motivuar nga persona të tjerë të përmendur në pikën 1, ku argumentohet pamundësia e realizimit të qëllimit të aksesit vetëm nëpërmjet konsultimit të vendimit, gjykata miraton aksesin fizik në të gjithë dosjen sipas procedurës të parashikuar në nenin 11 të këtij Udhëzuesi.3.* ***Në çdo rast, personi që kërkon akses është i detyruar të ruajë konfidencialitetin e informacionit duke nënshkruar deklaratënpërkatëse.”*** **(Gjykata nuk ka mjete mbi provimin e nënshkrimit elektronik, ndaj kërkohet nënshkrimi manual.)**<br>b. Gjykata për dhënien e informacionit për kërkesat e paraqitura nga media ka operuar në përputhje me parimet e përcaktuara me Vendim Nr. 716, datë 06.12.2023 “Udhëzues Standard të Marrëdhënieve të Gjykatave me Publikun dhe Median Neni 2/ 3. “*Media trajtohet në mënyrë të barabartë, pa diskriminim ndërmjet përfaqësuesve të saj, duke shmangur krijimin ose mbajtjen e kanaleve të komunikimit dhe informuese të privilegjuara me përfaqësues të caktuar të saj.*”. **(*Ndaj për secilën nga mediat që ka kërkuar informacion me kërkesë të karakterit jopublik nga Gjykata është ndjekur procedurë e njëjtë identifikimi dhe dhënia e informacionit pa identifikim të plotë është refuzuar duke zbatuar parimin për trajtim të barabartë.)*** | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 3. Ju informojmë se disa nga vendimet e shkurtuara me objekt “Caktim dhe vleftësim të masës së sigurisë” për çëshjet e kërkuara janë bërë publike vlerësuar nga gjykata si informacion publik pa kërkesë, duke vlerësuar kështu interesin dhe të drejtat e publikut për t’u informuar mbi veprimtarinë e gjykatës bazuar në Vendim Nr. 716, datë 06.12.2023 “Udhëzues Standard të Marrëdhënieve të Gjykatave me Publikun dhe Median” dhe Ligj nr.119/2014“Për të Drejtën e Informimit”; të cilat i gjeni në lidhjen si në vijim: https://gjykata.gov.al/rrethi-elbasan/gjykata-e-shkall%C3%ABs-s%C3%AB-par%C3%AB-e-juridiksionit-t%C3%AB-pergjithsh%C3%ABm-elbasan/pasqyra-e-shtypit/<br><br>Lidhur me kërkesën tuaj nga kontrolli ushtruar dosjet për të cilat kërkoni informacion janë në përpunim nga gjyqtarët e çështjeve.<br><br>Kërkesat me objekt “Masë Sigurimi”, me kërkues Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, janë regjistruar në kategorinë "Kërkesa në Fazën e Hetimit Paraprak" me bazë ligjore “Material i Mbyllur”. Dosjet për këto çështje janë ende nën hetim dhe në përpunim. Në këto kushte për shkak të detyrimit ligjor që rrjedh nga Neni 279/3/b. i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë : *“Detyrimi për të Ruajtur Sekretin Hetimor” i cili përcakton në pikën 3.b “Ndalimin e publikimit të përmbajtjes së akteve të veçanta apo të dhënave të posaçme që lidhen me veprime hetimore të caktuara*”, janë akte nga dosjet që nuk mund t`u jepen palëve të treta. | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Vendimet për masat e sigurisë: në faqen zyrtare të gjykatës Elbasan dhe Gjykatës së Apelit, gjeni të publikuar shkurtimet e vendimeve të disa prej tyre si informacion publik pa kërkesë.<br><br>Vendimet për kërkesat për pushim të hetimeve janë në përpunim.<br><br>Gjykimet në seancë paraprake, sikurse masat e sigurimit zhvillohen me dyer të mbyllura që do të thotë janë sekret hetimor, në këto kushte për shkak të detyrimit ligjor që rrjedh nga Neni 279/3/b. i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë : *"Detyrimi për të Ruajtur Sekretin Hetimor"* i *cili përcakton në pikën 3.b "Ndalimin e publikimit të përmbajtjes së akteve të veçanta apo të dhënave të posaçme që lidhen me veprime hetimore të caktuara"*, në këtë kuptim përfshihen edhe kërkesat për pushim/dërgim në gjyq, janë akte nga dosjet që nuk mund t`u jepen palëve të treta.<br><br>Ndaj kthim/përgjigjes për kërkesën tuaj, mund të ankoheni pranë "Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale", në përputhje me nenin 24/1,2/a të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit".<br><br>Me konsideratë,<br><br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | | | |
| 36 | 02.07.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues S.S.**<br><br>*Pershendetje Znj. Manjola*<br><br>*Ju lutem mundet te na dergoni/publikoni listat e gjyqeve per kete jave ne faqen web te gjykates?*<br><br>*Faleminderit per mirekuptimin! S.S* | **Përgjigje 36.**<br><br>Përshëndetje,<br><br>Listat i gjeni në lidhjen si në vijim.<br><br>https://gjykata.gov.al/rrethi-elbasan/gjykata-e-shkall%C3%ABs-s%C3%AB-par%C3%AB-e-juridiksionit-t%C3%AB-pergjithsh%C3%ABm-elbasan/njoftime/ | 03.07.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Faleminderit<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | | | |
| 37 | 03.07.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues N.T.**<br><br>*Prsh cfare duhet te plotesoj qe te vendosni emrin tek lista e avokateve te gjykates flm*<br><br>*N. t 069………..* | **Përgjigje 37.**<br><br>Përshëndetje,<br><br>Dërgoni kërkesën tuaj në Dhomën Kombetare të Avokatisë..<br><br>Faleminderit<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | 04.07.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |
| 38 | 04.07.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues A.M.**<br><br>*Pershendetje Manjola kam bere nje kerkese para disa kohesh dhe ka qe ne korrik te 2023 ne pritje te nje pushimi ceshtje, kam ardh pas nje viti prape me pushime dhe akoma skam nje vendim per kete ceshtje desha te me mirkuptoni si mund te kominikoj apo te kontaktoj me Gjyqtaren pasi kam nje vit qe kam kryer pagesat per rregullimin e mjetit dhe pres demahperblimin nga ana e kompanis dhe duke qene se jam emigrant koha ne shqiperi eshte e shkurter ju faleminderit ne pritje te nje pergjigje nga ana juaj*<br><br>*A.M.*<br>*Cell:34………* | **Përgjigje 38.**<br><br>Përshëndetje i nderuar,<br><br>Kërkesat në lidhje me çështjet në gjykim përcillen në sekretarinë gjyqësore.<br>Kërkesat tuaja janë referuar.<br>Në lidhje me vendimmarrjen njoftoheni sipas procedurës.<br><br>Faleminderit<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | 05.07.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |
| 39 | 08.07.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues L.M.**<br><br>*Si perfaqesuese e kerkuesit R.K kerkojme vendimin gjyqesor me forme te prere. Vendimi mban nr………………. ( prokura gjendet ne dosje)* | **Përgjigje 39.**<br><br>Përshëndetje,<br><br>Vendimi ka marrë formë të prerë datë 12.06.2024. | 08.07.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *(Meqenese jemi ne Shkoder kontaktoni ne kete email per njoftim).*<br><br>*Me respekt*<br>*Av. L.M* | Për kopje të vlefshme për dokumentacion të vendimit paraqituni në kryesekretarinë e gjykatës.<br><br>Faleminderit<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | | | |
| 40 | 08.07.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues L.K.**<br><br>*Përshëndetje,*<br><br>*Në kuadër të plotësimit të pyetësorit të Zyrës së OKB-së për Drogat dhe Krimin (UNODC) lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore, lutemi nga gjykatat tuaja përcjelljen e informacioneve të kërkuara në pikat e mëposhtme:*<br><br>***Rubrika: Offenders – (Shkelësit)***<br><br>***Plotësimi i informacionit të kërkuar për këtë rubrikë nevojitet për vitet 2018-2023 (të ndara sipas viteve), në përputhje me nënçështjet e referuara në tabelë për secilën nga pikat e mëposhtme:***<br><br>***-Pika 4*** *"Persons convicted of trafficking in persons (preferably convicted in the court of first instance)" – (Personat e dënuar për trafikim të qenieve njerëzore)*<br>***-Pika 5*** *"Persons convicted of trafficking in persons by forms of exploitation"- (Personat e dënuar për trafikim të qenieve njerëzore, me forma shfrytëzimi)*<br>***-Pika 6*** *"With reference to Question 4, please list the citizenships and number of persons convicted of trafficking in persons. Please start with the citizens of your own country". – (Në referim të pyetjes 4, listoni shtetësinë e personave të dënuar për trafikim të qenieve njerëzore duke filluar nga shtetasit shqiptarë)*<br><br>***Rubrika: Court Case - (Çështje gjyqësore)***<br><br>*Referuar kësaj rubrike, lutemi përcjelljen e një informacioni të përmbledhur mbi një çështje të rëndësishme gjyqësore të përfunduar me dënim për trafikim të qenieve njerëzore,* ***gjatë viteve 2021-2023****, i cili duhet të përmbajë:* | **Përgjigje 40.**<br><br>Përshëndetje e nderuar,<br><br>Kërkesa është marrë në shqyrtim dhe po përpunohet.<br><br>Faleminderit<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al<br><br>**Përgjigje 40/1**<br><br>Përshëndetje e znj. L.K.,<br><br>Duke shprehur konsideratën tonë për veprimtarinë tuaj, në përgjigje të kërkesës tuaj të dërguar në postën elektronike të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan më datë 25.06.2024, me objekt " Kërkesë për infromacion në kuadër të plotësimit të pyetësorit të Zyrës së OKB-së për Drogat dhe Krimin (UNODC) lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore", ju bëjmë me dije se në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të Drejtën e Informimit", kërkesa për dhënie informacioni është shqyrtuar.<br><br>Për plotësimin e formularit i jemi referuar të dhënave të kërkuara bazuar në filtrat e Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë të | 08-09---07.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *-Detaje mbi fazën hetimore dhe operacionin e shpëtimit;*<br>*- Profili i viktimave (gjinia, mosha, kombësia, prejardhja socio-ekonomike, çdo faktor tjetër relevant)*<br>*- Profili i shkelësit*<br>*- Lloji i shfrytëzimit dhe mjetet e përdorura;*<br>*- Rrethana rënduese (nëse ka).*<br><br>*Afati për plotësimin e pyetësorit nga ana juaj është data* ***10.07.2024.***<br><br>*Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, bashkëlidhur do të gjeni pyetësorin e Zyrës së OKB-së për Drogat dhe Krimin (UNODC), në të cilin janë shenjuar me ngjyrë të verdhë pikat që duhet të plotësohen nga ana juaj.*<br><br>*L.K.*<br>***Specialiste, Sektori i Oponences Juridike dhe Perafrimit te Legjislacionit*** | Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, referuar bazës ligjore si në vijim:<br><br>• ***Neni 110/a*** *Trafikimi i personave të rritur (Shtuar me ligjin 8733, datë 24.1.2001; ndryshuar me ligjin nr. 9188, datë 12.2.2004; ndryshuar titulli, fjalët në paragrafin e parë dhe paragrafi i tretë dhe shtuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 144, datë 2.5.2013; shfuqizuar pjesa që parashikon edhe dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim, me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013)*<br>• ***Neni 110/b*** *Përfitimi apo përdorimi i shërbimeve të ofruar nga personat e trafikuar (Shtuar me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013) Përfitimi apo përdorimi i shërbimeve të ofruar nga personat e trafikuar, apo i shërbimeve që janë objekt i shfrytëzimit nga trafikimi, duke pasur dijeni që personi është i trafikuar, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet. 78 Kur kjo vepër kryhet ndaj një fëmije dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.*<br>• ***Neni 110/c*** *Veprimet që lehtësojnë trafikimin (Shtuar me ligjin nr.144, datë 2.5.2013) Falsifikimi, zotërimi ose sigurimi i dokumentit të identitetit, i pasaportave, i vizave ose i dokumenteve të tjera të udhëtimit apo mbajtja, heqja, fshehja, dëmtimi ose shkatërrimi i tyre, që kanë shërbyer për trafikimin e personave të rritur, por pa pasur dijeni për këtë fakt, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë, apo është kryer nga personi që ka për detyrë të lëshojë letërnjoftimin, pasaportën, vizën apo dokumentin e udhëtimit, ose ka mundësuar trafikimin e fëmijëve, dënohet me burgim nga katër deri në tetë vjet. Po kjo vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim jo më pak se pesë vjet.*<br>• ***Neni 114*** *Shfrytëzimi i prostitucionit (Ndryshohet titulli dhe shfuqizuar paragrafi II me ligjin nr. 8279, datë 15.1.1998; ndryshuar me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013)*<br>• ***Neni 128/b*** *Trafikimi i të miturve (Shtuar me ligjin nr. 8733, datë 24.1.2001; ndryshuar me ligjin nr.* | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | *9188, datë 12.2.2004; shtuar me ligjin nr. 9859, datë 21.1.2008; ndryshuar fjalët në paragrafin e parë me ligjin nr. 144, datë 2.5.2013; shfuqizuar pjesa që parashikon edhe dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim, me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013*).<br><br>Nga kontrolli ushtruar rezultojnë:<br><br>• ***Viti 2018 regjistrohet një çështje me të akuzuar për veprën penale 114/1 i Kodit Penal "Shfrytëzim prostitucioni", rezulton vendim dënimi, shtetas shqiptar.***<br>• ***Viti 2019 regjistron një çështje me te akuzuar për veprën penale 114/1 i Kodit Penal "Shfrytëzim prostitucioni", vendim dënimi, shtetas shqiptar.***<br>• ***Viti 2020 regjistron një çështje akuzuar për veprën penale "Trafikimi i të miturve", parashikuar nga neni 128/b, paragrafi i tretë, vendim dënimi, shtetas shqiptar.***<br><br>Në përgjigje të pyetjes së dytë për vitet 2021-2023, nuk rezultojnë të dhëna për regjistrim çështjesh gjyqësore që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore Neni: 110/a; 110/b; 110/c; 114; 128/b.<br><br>Bashkëlidhur gjendet formulari.<br><br>***Mbetemi në kontakt për çdo paqartësi në lidhje me plotësimin e formularit.***<br><br>Ju urojmë punë të mbarë<br><br>Me konisderatë<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 41 | 05.07.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues S.K.**<br><br>*Pershendetje jam avokate prane Dhomës Avokateve Tirane ne listën e avokateve kryesisht Elbasan ndodhem e kerkoj te me hiqet emri nga kjo liste ne te drejte ushtrimi rajonal dhomash .*<br>*Faleminderit*<br>*Av. S.C*<br><br>*Pershendetje i jam drejtuar qekur kam ber e transferimin ne 2019,sipas kartës anëtarësimit bashkangjitur:mund te hiqet nga lista avokateve kryesisht ne keto kushte.*<br>*Pune e mbare,*<br>*Av.S.C* | **Përgjigje 41.**<br><br>Tue 7/9, 9:59 AM<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju lutem drejtoni kërkesën tuaj Dhomës Kombëtare të Avokatisë Elbasan për të kryer veprimet me gjykatën.<br><br>Faleminderit<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al<br><br>**Përgjigje 41/2**<br><br>Tue 7/9, 12:02 PM<br><br>Përshëndetje,<br><br>Kërkesa i është përcjelle për veprime IT-së së Gjykatës.<br><br>Faleminderit<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al<br><br>Wed 7/10, 1:46 PM<br><br>Pershendetje,<br><br>Me kerkese te saj kerkon te hiqet nga lista qe rezulton per avokatet kryesisht ne kete lidhje.<br><br>https://gjykata.gov.al/rrethi-elbasan/gjykata-e-shkall%C3%ABs-s%C3%AB-par%C3%AB-e-juridiksionit- | 05.--11.07-2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | t%C3%AB-pergjithsh%C3%ABm-elbasan/gjykata/dhoma-e-avokatis%C3%AB/<br><br>Nese ka procedura te tjera per menyren e vendosjes dhe heqjes nga faqja zyrtare ne mailin keni kontaktet.<br>Faleminderit.<br><br>Thu 7/11, 11:14 AM<br><br>Përshëndetje,<br><br>Kërkesa është konfimuar nga IT-së i Gjykatës dje dt 10.07.2024.<br><br>Faleminderit<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | | | |
| 42 | 11.07.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues R.M.**<br><br>*Pershendetje e nderuar,*<br>*Une av. R.M, anetare e Dhomes se Avokatise Fier, me nr lic …… jam perfaqesuese e znj. G.P, ne nje proces civil ne Gjykaten e Apelit te Juridiksionit te Pergjithshem Tirane me objekt " Njohjen e Vendimit te Huaj". Seanca gjyqesore eshte caktuar ne daten 17 Korrik dhe ora 14.45.*<br>*Nje nga provat qe duhet te paraqesim ne ate proces gjyqesor, eshte edhe vertetimi se nuk proces civil te rregjistruar prane Jush, nga qytetarja G.P.*<br>*Ne keto kushte, kur ky vertetim eshte i domosdoshem, dhe bazuar ne Ligjin " Per profesionin e avokatit ne Republiken e Shqiperise", ju lutem te na pajisni me nje vertetim te tille.*<br>*Duke ju falenderuar per mirekuptimin*<br>*Me respekt*<br>*Av. R.M*<br>*06……* | **Përgjigje 42.**<br><br>Përshëndetje,<br><br>Ju informojmë se për tu pajisur me vërtetime duhet të paraqiteni fizikisht në gjykatë për të plotësuar formularin e aplikimit, pas pagesës së tarifave gjyqësore do të njoftoheni nga nëpunësit përkatës për tërheqjen e tyre.<br><br>Faleminderit<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al<br><br>**Përgjigje 42/1**<br><br>Përshëndetje,<br><br>Formulari plotësohet në prani të nëpunëst të caktuar.<br>Mund të paraqitet pala ose përfaqësuesi ligjor duke u identifikuar secili nëpërmjet mjeteve identifikuese. | 11.07.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *Ne vijim te komunikimit me Ju, nese eshte e mundur formularin t'ua nis te plotesuar ne rruge elektronike ose te paraqitet nje familjar prane Jush?* | Faleminderit<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | | | |
| 43 | 14.07.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues E.B.**<br><br>*Une jam Shtetasi E.B.*<br>*Ju lutem shume ne qofte se nuk e keni ju fuqine per te hequr kete informacion me ceshtjen time personale qe ndodhet ne Google nga Gjykata, me orientioni ku te drejtohem qe te hiqet ky informacion Gjykate persa i perket ceshtjes time Gjygjesore nga Google, ku cdo kush mund te futet dhe mjafton te shkruaj te dhenat e mija dhe e shikon ne Google situaten time me ceshtje personale.*<br>*Kjo nuk eshte e drejte. Ndihem i pa sigurte per sigurine e privatesise te imazhit tim nga Shteti Shqiptar. Jepini rendesi mesazhit tim sepse nuk do ta lejoj ne asnje menyre qe te vazhdoj te qendroj ne Google ky informacion. Ne qofte se nuk do i jepet zgjidhje ketij problemi te shkaktuar vet nga instuticionet e drejtesise te Shtetit Shqiptar do vazhdoj me tej deri sa ti jepet zghidhje ketij problemi te shkaktuar vete nga ju qe jeni pjese e instuticioneve te drejtesise te Shtetaseve Shqiptar.Emisionet dhe mediat si Fiks Fare apo Stop gjithashtu dhe media te tjera do jene ne dijeni ne rast se nuk me ktheni pergjigje dhe nuk i jepni rendesi shqetesimit tim me te drejtat e mija personale si qytetar i rregullt dhe taksapagues.Ne qofte se ju duket kercenues mesazhi im esht kuptim i gabuar nga ju. Vereni veten tuaj ne pozicionin ……………….*<br><br>*Ju lutem me mirkuptoni*<br>*pres pergjigje :*<br>*Me Rrespekt: Shteasi: E.B.* | **Përgjigje 43.**<br><br>Përshëndetje,<br><br>Jeni duke komunikuar me Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.<br><br>Nga kontrolli ushtruar rezulton që materiali është njoftim me shpallje publike për njoftimet e seancave gjyqësore që i përket një tjetër gjykate.<br><br>Drejtohuni me shkresë gjykatës përkatëse.<br><br>Faleminderit<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | 15.07.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |
| 44 | 17.07.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim.**<br><br>*Pershendetje,*<br>*Po ju shkruaj duke qene se duke kontrolluar ne website e gjykates me rezulton se me 8 korrik eshte bere nje seance. Nderkohe qe sipas dijenise sime dhe te avokatit qe me perfaqeson seanca e fundit eshte bere me 12 qershor dhe eshte mbyllur si ceshtje dhe u tha qe do jemi ne pritje te zbardhjes se vendimit. U jam drejtuar dhe fizikisht prane gjykates per tejzgjatjen e ketij divorci pasi po qendroj ende peng ligjerisht.*<br>*Bashkangjitur Id dhe foto nga website i gjykates.* | **Përgjigje 44.**<br><br>Përshëndetje znj. G.R.<br><br>Në përgjigje të kërkesës suaj të depozituar në adresën zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan manjola.kume@gjykata.gov.al më datë 17.07.2024 me objekt "Kërkesë për informacion", ju bëjmë me dije se në përputhje me Ligji nr.119/2014, "Për të Drejtën e Informimit", kërkesa juaj është shqyrtuar dhe nga kontrolli ushtruar rezulton se ju keni caktuar përfaqësues | 18.07.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | ligjor z. U.D.. Më datë 15.07.2024 është dërguar dëftesa komunikimit të vendimit nga Kryesekretaria e Gjykatës.<br><br>Faleminderit<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | | | |
| 45 | 18.07.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues O.T.**<br><br>*Kërkoj akses në faqen zyrtare online te Gjykatës në funksion të vëzhgimit "të listës së avokatëve të caktuar kryesisht për 2024 përmes **dërgimit të "linkut"**. Nuk është i nevojshëm mjeti i identifikimit. "E-mail" është regjistruar në "QKB".*<br>*O.T*<br>*Avokate në formën e personit fizik -Elbasan* | **Përgjigje 45.**<br><br>Përshëndetje e nderuar,<br><br>Mund të aksesoni listën e avokatëve në lidhjen si në vijim:<br><br>https://gjykata.gov.al/rrethi-elbasan/gjykata-e-shkall%C3%ABs-s%C3%AB-par%C3%AB-e-juridiksionit-t%C3%AB-pergjithsh%C3%ABm-elbasan/gjykata/dhoma-e-avokatis%C3%AB/<br><br>Faleminderit<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | 18.07.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |
| 46 | 08.07.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues R. A**<br><br>*Ankim për çështje në gjykim me palë A.A nga R.A.,*<br>*Me respekt R. A.* | **Përgjigje 46.**<br><br>Përshëndetje,<br><br>Bashkëlidhur këtij komunikimi elektronik gjendet kthim përgjigje e shkresës Nr. …… Prot., sipas ankesës së paraqitur në Këshillin e Lartë gjyqësor nga adresa a................@gmail.com.<br><br>Për çdo paqartësi, kërkesë, ankesë jeni të mirëpritur të paraqiteni në Zyrën e Protokollit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me mjet identifikimi të kërkuesit duke plotësuar formularët përkatës.<br><br>Faleminderit<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan | 12.07.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al<br><br>-------------------------------------------------------------<br><br>Duke shprehur konsideratën tonë për veprimtarinë tuaj, në përgjigje të kërkesës suaj të depozituar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan më datë 04.07.2024 me objekt "Verifikim i ankesës", me Nr. ....... Prot., ju bëjmë me dije se në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të Drejtën e Informimit", kërkesa është regjistruar me Nr……. Prot., datë 08.07.2024, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.<br>Ju informojmë se kërkesa është shqyrtuar dhe pas kontrollit të ushtruar, rezulton se:<br>- Seancat gjyqësore për shtetasin në proces gjyqësor penal në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, z. A,A, janë zhvilluar sipas planifikime të caktuara.<br>- Shtyrjet e seancave gjyqësore janë kryer për arsye objektive sipas akteve që janë pjesë e dosjes gjyqësore, përkatësisht:<br>• Seanca gjyqësore e caktuar në datën ......, është zhvilluar dhe është shtyrë për "Prova Shkresore";<br>• Seanca gjyqësore e caktuar në datën ......, është zhvilluar dhe është shtyrë në datë ....., për "Rinjoftim Prokurori";<br>• Seanca e datës ....... është shtyrë për arsye objektive të pjesëmarrjes të gjyqtares së çështjes në aktivitetin trajnues në Shkollën e Magjistraturës datë ......me ftesë të Shkollës së Magjistraturës;<br>• Planifikimi kalendarik i seancës .........., për të cilën rezulton marrja e aktit njoftues fletë- thirrje Nr. ..... Akti., datë ....... dhe planifikimi i secancës gjyqësore në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore është kryer sipas urdhërit të gjyqtares së çështjes, për shtyrjen e seancës gjyqësore të datës ....... në datë .......;<br>- Nga kontrolli ushturar rezulton se shtetasi z. A.A., ka emëruar përfaqësues ligjor të posaçëm me prokurë të | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | posaçme Nr.Rep., .... dhe ... Kol., datë ....për përfaqësimin e tij avokaten znj. S.L<br>- Nga kontrolli ushtruar rezulton se perfaqësuesja ligjore e posaçme e shtetasit z. A.a znj. S.L., ka marrë dijeni për zhvillimet e seancave gjyqësore dhe arsyet e shtyrjes së seancave me prezencë të saj në gjykim.<br><br>Në zbatim të Nenit 70 të Kodit Civil i cili përcakton: "*Prokura është dokumenti në të cilin i përfaqësuari, me vullnetin e tij të lirë ka përcaktuar karakterin dhe vëllimin e tagreve që i ka dhënë përfaqësuesit" dhe nenit 71. Paragrafi 2.,* i cili përcakton se:<br><br>*Prokura është e posaçme kur i përfaqësuari i k*<br>*a dhënë përfaqësuesit tagrin për të kryer një ose disa veprime juridike të caktuara, që karakterizohen nga një qëllim i përbashkët*",  z. A.A ka shprehur vullnetin e tij duke emëruar përfaqësues ligjor me prokurë të posaçme Nr.Rep., .... dhe ..... Kol., datë ..... për përfaqësimin e tij në këtë çështje avokaten znj. S.L., prokura është pjesë  e akteve të dosjes gjyqësore.<br>Ju informojmë se në zbatim të një procesi të rregullt ligjor, avokatja znj. S.L., e emëruar me prokurë të posaçme nga i përfaqësuari z. A.A., mund t`i drejtohet në çdo kohë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me kërkesë pranë Zyrës së Protokollit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan  për pajisjen me aktet e dosjes së çështjes në gjykim të shtetasit z. A.A.<br>Bashkëlidhur shkresës konfirmim i dërgimit të kthim përgjigjes Nr. ......  Prot., në e- mail .......... datë 12.07.2024.<br><br>Mbetemi në gadishmërinë tuaj për çdo paqartësi!<br>Me konsideratë,<br><br>**KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT**<br>**Manjola Kume** | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 47 | 22.07.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues S.S.**<br><br>*Kërkesë për pajise me kopje të akteve të dosjes*<br>*S.S* | **Përgjigje 47.**<br><br>Përshëndetje,<br><br>Për t`u pajisur me kopje të akteve të dosjes drejtohuni në Zyrën e Arkivës së Gjykatës, pas pagesës së shpenzimeve gjyqësore do të njoftoheni nga nëpunësit për tërheqjen e tyre.<br><br>Faleminderit<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | 23.07.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |
| 48 | 23.07.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues L.C.M**<br><br>*Pershendetje Manjola, si jeni?*<br><br>*Ne vijim te bashkepunimit me institucionin tuaj ne kuader te mbledhjes se te dhenave mbi vrasjet e grave dhe vajzave,*<br><br>*lutemi te na informoni nese eshte ankimuar vendimi nr.364 ndaj autorit R.M. ?*<br><br>*Faleminderit per bashkepunimin!*<br><br>*Me respekt,*<br>*l. C. M*<br>*Konsulente Ligjore*<br>*Avokati i Popullit* | **Përgjigje 48.**<br><br>Përshëndetje,<br><br>Në përgjigje të kërkesës suaj të depozituar në adresën zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan manjola.kume@gjykata.gov.al më datë 23.07.2024 me objekt "Kërkesë për informacion", ju bëjmë me dije se në përputhje me Ligji nr.119/2014, "Për të Drejtën e Informimit", kërkesa juaj është shqyrtuar dhe nga kontrolli ushtruar në Kryesekretarinë e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për shtetasin **R.M.,** akuzuar per kryerjen e veprës penale **"Vrasje për shkak të marrëdhenieve familjare "** të parashikuar nga neni 79/c të Kodit Penal dhe dënuar me burgim të përjetshëm për vrasjen e shtetases **J.E.,** me vendim **13-……….** shpallur më datë **26.07.2023** rezulton se vendimi ka marrë formë të prerë më datë 28.03.2024.<br><br>**Manjola Kume**<br>**Koordinatore e të Drejtës së Informimit**<br>**Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Median**<br>E-mail: manjola.kume@gjykata.gov.al<br>Adresa: Lagjja "5 Maji", Rruga "Koço Brisku", Elbasan, Shqipëri<br>Tel: 054 25 99 51<br>Web: www.gjykataelbasan.gov.al | 24.07.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | **Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan \| Elbasan First Instance Court of General Jurisdiction** | | | |
| 49 | 22.07.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues R.A.**<br><br>*Pershendetje.Me falni per shqetesimin une qe Po Ju shkruaj quhem R.A .Sic dhe jeni vendosur ne dijeni per problemin tim jeni pergjigjur mbi arsyet e shtyrjes se gjygjit te djalit tim por e nderuar pervecse me eshte thene qe eshte e semure me raport.E nderuar nese kontolloni mbi ecurine e gjygjit do te vereni se gjygji vjet ne qershor ishte gati per vendim .iku prokurori u nis nga e para.me pas iku gjygjtarja u nis serisht Po e njera procedure dokumentat te gjitha nga e para .Tani qe u plotesuan te gjithe dokumentat dhe ishte per vendim u la per ne shtatore qe te me nis serisht nga e para me largimin e prokurorit.E nderuar gjygji ishte thjesht per llogaritje keshtu u shpreh dhe prokurori vjet ne salle .prokurori u shpreh qe kane mbaruar afatet .Thjesht eshte i ka mbushur apo jo afatet nese do te shikojme praktika gjygjesh te ngjashme mund te behen vetem me dy seanca e shumta .E nderuar pres te me mirkuptosh jam e pafuqishme nuk mundem dot me gjithe kete sorollatje .Pres nje zgjidhje nga ana juaj* | **Përgjigje 49.**<br><br>Përshëndetje e nderuar znj. R.A,<br><br>Në përgjigje të kërkesës suaj të depozituar në adresën zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan manjola.kume@gjykata.gov.al më datë 22.07.2024 me objekt "Kërkesë pëinformacion", ju bëjmë me dije se në përputhje me Ligj nr.119/2014, "Për të Drejtën e Informimit", kërkesa juaj është shqyrtuar dhe nga kontrolli ushtruar rezulton se ju është kthyer përgjigje me shkresën me Nr. ……… Prot., dërguar Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe bashkëlidhur për dijeni në e-mailin a.................@gmail.com , më datë 12.07.2024.<br><br>Çështja është në status në përpunim dhe pala në gjykim z.A.A., ka caktuar përfaqësues ligjor me prokurë të posaçme, i cili ka dijeni mbi ecurinë e procesit dhe planifikimet e seancave gjyqësore.<br><br>*Faleminderit*<br>**Manjola Kume**<br>**Koordinatori për të Drejtën e Informimit**<br>**Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Median**<br>E-mail: manjola.kume@gjykata.gov.al<br>Adresa: Lagjja "5 Maji", Rruga "Koço Brisku", Elbasan, Shqipëri<br>Telefon: 0035554 25 99 51<br>Website: www.gjykataelbasan.gov.al<br>**Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan \| Elbasan First Instance Court of General Jurisdiction** | 24.07.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |
| 50 | 25.07.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues R. Y.**<br><br>*Mirmengjesi. E nderuar zonja gjygjtare ne shkresen qe me keni nisur mua dhe keshillit te larte te drejtesise i jeni referuar vetem gjygjeve te caktuara kete vit .E* | **Përgjigje 50.**<br><br>Përshëndetje e nderuar, | 25.07.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *nderuar Po te shikoni per me shume do te gjeni qe ceshtja nuk ka nisur kete vit dhe gjithashtu do te shikoni qe gjykata i ka kerkuar provat shkencore shume me pare qe me gjygjtaren …….. dhe prokuror ……… dhe ne seance u tha qe per mbledhjes se provave ishte vetem perllogaritja i kishte mbushur 10 vjet nga vendimi i fundit apo jo ku prokurori u shpreh qe i ka kaluar te gjitha afatet .pas shume shtyrjesh nga ana e gjygjtares do japim vendim sot .vendim neser derisa u largua prokurori erdhi prokurori …………. u be nje seance tjeter dhe gjygjtarja nuk e dha vendimin se do te largohej.Erdhi gjygjtarja ………… i kerkoj te gjitha nga e para dhe kur u plotesuan serisht me dt te fresketa filluan shtyrjet serisht.Shtyrjen e fundit kaq larg u be me qellim mos te mbyllej ceshtja se è dinin qe prokurori ishte ne proces vetigu.Po gjygjet e tjera e nderuar kaq large sa gjygji im jane vendosur? E nderuar keni praktika te tjera njesoj si kjo po tek e njejta gjygjtare por nuk veprohet keshtu.E nderuar kam shume vite qe zvarritem dyerve te gjykates pa gjetur zgjidhje.kerkesa ime ishte te kontrollonit Cfar eshte bere me kete ceshtje nga fillimi dhe jo car ka ndodhur 6 muajt e fundit.E nderuar une kerkova mirkuptim dhe ndihme per ta pare seriozisht ceshtjen time sepse nuk ka sens qe gjykata te lejoje qe te zvarritet nje ceshtje qe eshte e vendosur me ligj qe ne momentin qe mbush 10 vjet nga marrja e vendimit dhe nuk je arrestuar atehere behet shuarja e denimit pra e nderuar provat shkencore ishin eshte ndaluar ndonjehere apo jo dhe prokurori u shpreh po te ishte arrestuar sot do ishte ne burg. E nderuar pres ndihmen tuaj per zgjidhje te problemit .Me respekt R.A.* | Në përgjigje të kërkesës tuaj, ju informojmë sërisht se pala në proces gjyqësor ka caktuar përfaqësues ligjor me prokurë të posaçme.<br>Përfaqësuesi ligjor mund të paraqesë në çdo kohë kërkesë për njohjen me aktet e dosjes.<br><br>Ju informojmë se gjyqtarët kanë në shqyrtim një numër të lartë çështjesh për gjykim të caktuara me short elektronik fillestar, si edhe rishortim të çështjeve të gjyqtarëve të larguar.<br><br>Çdo proces gjyqësor përfundon me vendimmarrje.<br>Komunikimi i vendimmarrjes i komunikohet palëve në proces gjyqësor dhe përfaqësuesve ligjor sipas normave ligjore të legjislacionit në fuqi.<br>Caktimi i datave të seancave gjyqësore është kompetencë e gjyqtarit të çështjes.<br>Në vendimin e arsyetuar përcaktohen dhe afatet mbi të drejtën e ankimimit.<br><br>Faleminderit<br><br>**Manjola Kume**<br>**Koordinatore e të Drejtës së Informimit**<br>**Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Median**<br>E-mail: manjola.kume@gjykata.gov.al<br>Adresa: Lagjja "5 Maji", Rruga "Koço Brisku", Elbasan, Shqipëri<br>Tel: 00355 54 25 99 51<br>Web: www.gjykataelbasan.gov.al<br>**Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan \| Elbasan First Instance Court of General Jurisdiction** | | | |
| 51 | 26.07.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim. A.Sh.**<br><br>*Jam bashkshortja e A.SH. dua te informohem ne lidhje me ceshtjen gjyqesore te tij pasi na esht njoftuar se ka nje seanc gjyqesore ne dat 30.07.2024 po ju bashkangjis dhe mjetin e indetifikimit te tij* | **Përgjigje 51.**<br><br>Përshëndetje,<br><br>Në përgjigje të kërkesës suaj të depozituar në adresën zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan manjola.kume@gjykata.gov.al më datë 26.07.2024 me objekt "Kërkesë për informacion", ju bëjmë me dije se në përputhje me Ligj nr.119/2014, "Për të Drejtën e Informimit", kërkesa juaj është shqyrtuar. | 26.07.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Njoftimet mbi çështjet në gjykim i komunikohen palëve dhe përfaqëseve të tyre ligjor sipas përcaktime ligjore në fuqi.<br>Ju nuk rezultoni palë në proces.<br><br>Faleminderit<br><br>**Manjola Kume**<br>**Koordinatore e të Drejtës së Informimit**<br>**Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Median**<br>E-mail: manjola.kume@gjykata.gov.al<br>Adresa: Lagjja “5 Maji”, Rruga “Koço Brisku”, Elbasan, Shqipëri<br>Tel: 00355 54 25 99 51<br>Web: www.gjykataelbasan.gov.al<br>**Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan \| Elbasan First Instance Court of General Jurisdiction** | | | |
| 52 | 09.09.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues E.B.**<br><br>*Pershendetje,*<br><br>*Nepemjet kësaj kërkesë elektronike dhe ne baze te nenit 154/a te K.Prc.C "Kërkesëpadia mund të paraqitet në gjykatë edhe nëpërmjet postës". ju lutem për vënien e informacionit ne lidhje me depozitimin e kerkese-padisë nëpërmjet shërbimit postar:*<br><br>*Bashkëlidhur kërkesë-padisë, në zarfin postar, a mund te vendos dhe vleftën e taksës së Gjykatës (prej 3.000 lekë) si dhe vleftën për njoftimin (prej 240 lekë) apo duhet të vendos pulla në shumat përkatëse, me qëllim që të depozitohet dhe të protokollohet kërkesë padia?*<br><br>*Duke ju falenderuar paraprakisht për kohën tuaj.*<br><br>*Me respekt*<br>*E.B.* | **Përgjigje 52.**<br><br>Përshëndetje!<br><br>Aktualisht pagesa nëpërmjet veprimeve bankare kryehen vetëm për ‘’Tarifë gjyqësore për kërkesë padi standarte ose 1% mbi vlerën e saj”.<br>Çdo pagesë tjetër kryhet fizikisht në sportelet e Gjykatës tek Arka në katin e parë.<br><br>**Manjola Kume**<br>**Koordinatore e të Drejtës së Informimit**<br>**Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Median**<br>E-mail: manjola.kume@gjykata.gov.al<br>Adresa: Lagjja “5 Maji”, Rruga “Koço Brisku”, Elbasan, Shqipëri<br>Telefon: 00355 54 25 99 51<br>Website: www.gjykataelbasan.gov.al<br>**Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan \| Elbasan First Instance Court of General Jurisdiction** | 10.09.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 53 | 09.09.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues B.K.**<br><br>*Pershendetje!*<br><br>*-Ju lutem kam nevoje per informacion nese ka nisur gjykimi per S.M., (lidhur me vrasjen qe ndodhi ne burgun e Peqinit)*<br><br>*-Nese ka nje date dhe ore per D.D seance e radhes.*<br><br>*Media B.K.* | **Përgjigje 53.**<br><br>Përshëndetje znj. B.K.<br><br>Në përgjigje të kërkesës suaj të depozituar në adresën zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan manjola.kume@gjykata.gov.al më datë 09.09.2024 me objekt "Kërkesë për informacion", ju bëjmë me dije se në përputhje me Ligji nr.119/2014, "Për të Drejtën e Informimit", kërkesa juaj është shqyrtuar dhe nga kontrolli ushtruar në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan rezultojn se:<br><br>- Për shtetasin S.M., nuk rezultojnë çështje në përpunim.<br>- Për seancën e shtetasit D. D., media u informua në seancë, seanca e rradhës është caktuar në datë ……. ora …….<br><br>Faleminderit<br><br>**Manjola Kume**<br>**Koordinatore e të Drejtës së Informimit**<br>**Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Median**<br>E-mail: manjola.kume@gjykata.gov.al<br>Adresa: Lagjja "5 Maji", Rruga "Koço Brisku", Elbasan, Shqipëri<br>Telefon: 00355 54 25 99 51<br>Website: www.gjykataelbasan.gov.al<br>**Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan \| Elbasan First Instance Court of General Jurisdiction** | 10.09.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |
| 54 | 04.09.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues S.C.**<br><br>*Përshëndetje,*<br>*Më poshtë do të gjeni kërkesën për informacion sipas modelit zyrtar të ligjit 119/2014 për të drejtën e informimit. Për çdo paqartësi apo pyetje, mund të më kontaktoni në të dhënat e vendosura në krye të kërkesës për informacion.* | **Përgjigje 54.**<br><br>Përshëndetje z. S.C,<br><br>Në përgjigje të kërkesës suaj të depozituar në adresën zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan manjola.kume@gjykata.gov.al më datë 04.09.2024 me objekt "Kërkesë për informacion", ju bëjmë me dije se në përputhje me Ligji nr.119/2014, "Për të Drejtën e Informimit", kërkesa juaj është shqyrtuar dhe nga kontrolli ushtruar në | 10.09.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | S.C<br><br>*1. Sa raste të martesave të shtetasve të mitur, nën moshën 18 vjeç, janë lejuar nga gjykata juaj në zbatim të nenit 7 të Kodit të Familjes gjatë periudhës 2017-2023? 2. Sa prej këtyre rasteve përfshijnë shtetas të mitur meshkuj dhe sa prej tyre përfshijnë shtetas të mitur femra? 3. Ju lutem të na siguroni kopje të vendimeve gjyqësore që kanë lejuar këto martesa, duke përfshirë edhe arsyetimin e gjykatës për çdo rast. Të dhënat të jenë të plota për të gjithë territorin nën juridiksionin e gjykatës – përfshirë ato para reformës, nëse të dhënat janë në arkivin tuaj.* | Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan rezulton se:<br><br>-Në lidhje me kërkesat me objekt “Lejim Martese” për vitet 2017- 2018, nga kontrolli ushtruar në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan rezulton1 (një) regjstrim kërkese me objekt “Lejim Martese”.<br>-Në lidhje me kërkesat me objekt “Lejim Martese” nga viti 2019-2023, nga kontrolli ushtruar në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan nuk rezultojnë regjstrime sipas këtij objekti.<br>- Përsa i përket kërkesës tuaj për dërgimin e vendimeve në lidhje me këtë objekt ju informojmë që jemi në përfundim të procesit të anonimizimit të vendimit.<br>-Ndërkohë më lejoni t`iu informoj mbi praktikën e ndjekur për dërgimin e vendimeve gjyësore referuar “Udhëzuesin Standard të Marrëdhënieve të Gjykatave me Publikun dhe Median” miratuar me Vendim datë 06.12.2023, nga Këshillit të Lartë Gjyqësor, në të cilën gjendet “Deklarata e Konfidencialitetetit” të cilën po e dërgojmë bashkëlidhur këtij komunikimi për plotësim, pas plotësimit të saj lutemi të ridërgohet bashkëlidhur kërkesës. Deklaratë plotësohet në zbatim të Ligj nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.<br><br>Mbetemi në kontakt për çdo paqartësi.<br><br>Me konsideratë,<br><br>**Manjola Kume**<br>**Koordinatore e të Drejtës së Informimit**<br>**Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Median**<br>E-mail: manjola.kume@gjykata.gov.al<br>Adresa: Lagjja “5 Maji”, Rruga “Koço Brisku”, Elbasan, Shqipëri<br>Telefon: 00355 54 25 99 51<br>Website: www.gjykataelbasan.gov.al<br>**Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan \| Elbasan First Instance Court of General Jurisdiction** | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *10.09.2024*<br><br>*Përshëndetj,*<br>*Më poshtë do të gjeni të plotësuar dhe firmosur, dokumentin "Deklarata e Konfidencialitetetit".*<br>*Mbetem në pritje të vendimit të cituar për vitet 2017-2018.* | **Përgjigje 54/1**<br><br>11.09.2024<br><br>Përshëndetje z. S.C,<br><br>Bashkëlidhur vendimi anonimizuar me objekt "Lejim Martese".<br><br>Me konsideratë,<br><br>**Manjola Kume**<br>**Koordinatore e të Drejtës së Informimit**<br>**Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Median**<br>E-mail: manjola.kume@gjykata.gov.al<br>Adresa: Lagjja "5 Maji", Rruga "Koço Brisku", Elbasan, Shqipëri<br>Telefon: 00355 54 25 99 51<br>Website: www.gjykataelbasan.gov.al<br>**Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan \| Elbasan First Instance Court of General Jurisdiction** | | | |
| 55 | 13.09.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues V.T.**<br><br>*Mirmengjes.*<br>*Mqs duam te iniciojme nje padi regresi prane Gjykates se Elbasanit, ju lutem na dergoni nje fature qe ta paguajme taksen e padise prane bankave te nivelit te dyte.*<br><br>*Bashkelidhur do gjeni nje kopje te padise.*<br><br>*Pune te mbare.*<br><br>*V.T* | **Përgjigje 55.**<br><br>Përshëndetje!<br><br>Bashkëlidhur fatura.<br><br>https://gjykata.gov.al/rrethi-elbasan/gjykata-e-shkall%C3%ABs-s%C3%AB-par%C3%AB-e-juridiksionit-t%C3%AB-pergjithsh%C3%ABm-elbasan/gjykata/rreth-gjykat%C3%ABs/<br><br>Faleminderit<br><br>**Manjola Kume**<br>**Koordinatore e të Drejtës së Informimit** | 13.09.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | **Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Median**<br>E-mail: manjola.kume@gjykata.gov.al<br>Adresa: Lagjja “5 Maji”, Rruga “Koço Brisku”, Elbasan, Shqipëri<br>Telefon: 00355 54 25 99 51<br>Website: www.gjykataelbasan.gov.al<br>**Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan \| Elbasan First Instance Court of General Jurisdiction** | | | |
| 56 | 18.09.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues P.K.**<br><br>*Pershendetje si jeni , si ja kaloni quhem P. dhe jam punonjese e OSFA fondacioni shoqeria e hapur . Ju njoftoj qe fondacioni jone ofron ndihme juridike falas per komunitetit rome dhe egjiptian ne Elbasan te cilet nuk munden ti ndjekin ne rruge gjyqesore ceshtjet e tyre ne qytetin e Elbasanit . Nese dispononi emra te cilet kanë nevoje per ndihme juridike falas ju lutem me njoftoni.*<br><br>*Faleminderit dhe Respekte*<br>*Numri im i kontaktit*<br>*068 .....*<br>*P.*<br>*OSFA ELBASAN.*<br>*Sent from my iPhone* | **Përgjigje 56.**<br><br>Përshëndetje znj. P.K.,<br><br>Ndihma juridike sanksionohet nga "Ligj Nr. 111/2017 Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti" për të gjithë shtresat në nevojë sipas kritereve të përcaktuara në ligj.<br>Shtetasit në nevojë i drejtohen për marrjen e shërbimit "Qëndrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Falas" të garantuar nga shteti.<br><br>Faleminderit<br><br>**Manjola Kume**<br>**Koordinatore e të Drejtës së Informimit**<br>**Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Median**<br>E-mail: manjola.kume@gjykata.gov.al<br>Adresa: Lagjja “5 Maji”, Rruga “Koço Brisku”, Elbasan, Shqipëri<br>Telefon: 00355 54 25 99 51<br>Website: www.gjykataelbasan.gov.al<br>**Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan \| Elbasan First Instance Court of General Jurisdiction** | 18.09.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |
| 57 | 24.09.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues B.C.**<br><br>*Pershedetje!*<br>*Prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Elbasan eshte rregjistruar ceshtja civile me pale paditese ....., me objekt " Zgjidhje Martese ".* | **Përgjigje 57.**<br><br>Përshëndetje!<br><br>Pagesa e padisë kryhet në sportel.<br>Vetëm taksa 1% kryhet nëpërmjet bankës. | 25.09.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *Ne cilesine perfaqesueses se pales paditese kerkoj nje informacion nese mund te paguaj taksen e padise me banke (duhet fature nga ana juaj) apo vetem me paraqitje ne sportel.Kam seancen e pare ne daten 30.09.2024 ora 11:45 dhe me duhet te kryeje kete pagese.*<br><br>*Duke ju falenderuar !*<br>*B.C.* | Ju lutem bashkëlidhni mjet identifikimi në kërkese që tiu informojmë mbi përditësimet e çështjes.<br><br>Faleminderit<br><br>**Manjola Kume**<br>**Koordinatore e të Drejtës së Informimit**<br>**Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Median**<br>E-mail: manjola.kume@gjykata.gov.al<br>Adresa: Lagjja "5 Maji", Rruga "Koço Brisku", Elbasan, Shqipëri<br>Telefon: 00355 54 25 99 51<br>Website: www.gjykataelbasan.gov.al<br>**Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan \| Elbasan First Instance Court** | | | |
| 58 | 26.09.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues Xh.A**<br><br>*Unë kërkuesja Xh.A, ju drejtohem me anë të kësaj kërkese për informacion bazuar në ligjin 119/2014 "Për të drejtën e informimit në Republikën e Shqipërisë, si më poshtë vijon;*<br><br>*1. Për arsye të një punimi kerkimor në lidhje me afatin e arsyeshem (neni 399/2 Kodit Procedures Civile), do të doja nga ana Juaj të dija, *se sa është numri i cështjeve të rregjistruara pranë Gjykatës suaj, që presim për t'u gjykuar deri më tani*?*<br><br>*- Sa më sipër, nga ana juaj kërkojë informacion për pytjet sa më lartë.*<br><br>*SQARIM: Ju theksoj gjithashtu se, referuar frymës që i jep ligji 119/2014 Për të drejtën e informimit, nuk cënojë asnjë informacion konfidencial të ndonjë shtetasi, pasi nga ana ime kjo kërkesë nuk i referohet ndonjë personi konkret, por një informacioni në përgjithësi.*<br><br>*- Kjo kërkesë dërguar me anë të kësaj poste elektronike, ka vlerë të plotë ligjore, referuar edhe nenit të mëposhtëm:*<br><br>*Neni 11, i ligjit 119/2014 parashikon se: Kërkesa për informim bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuesit dhe nënshkrimin e tij. Në çdo rast, kërkesa regjistrohet në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, të parashikuar në nenin 8 të këtij ligji.* | **Përgjigje 58.**<br><br>Përshëndetje,<br><br>Në përgjigje të kërkesës suaj të depozituar në adresën zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan manjola.kume@gjykata.gov.al më datë 26.09.2024 me objekt "Kërkesë për informacion", ju bëjmë me dije se në përputhje me Ligji nr.119/2014, "Për të Drejtën e Informimit", kërkesa juaj është shqyrtuar dhe nga të dhënat aktuale nga zyra e statisitkave rezultojnë këto të dhëna për vitin 2024**:**<br><br>**3 Mujori i parë viti 2024 çështja penale**:<br><br>1. Të mbartura 396<br>2. Të ardhura të reja 244<br>3. Gjithsej 639<br><br>**3 Mujori i parë viti 2024 çështja civile:**<br><br>1. Të mbartura 2141<br>2. Të ardhura të reja 554<br>3. Gjithsej 2695<br><br>**3 Mujori i dytë viti 2024 çështja penale**: | 30.09.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *Duke ju falenderuar në mirëkuptimin Tuaj, mbetem në pritje të përgjigjes suaj!* | 1. Të mbartura 462<br>2. Të ardhura të reja 144<br>3. Gjithsej 606<br><br>**Për 3 mujorin e dytë viti 2024 çështja civile rezulton shuma e përgjithshme 2620.**<br><br>*Ju informojmë se të dhënat përfundimtare për statistikat janë me bazë vjetore pasiqë në 3 mujor rezultatet janë në përpunim të vazhdueshëm.*<br><br>Rezultatet e statistikave vjetare për vitet 2018-2023 i gjeni të publikuara në lidhjen si në vijim: https://gjykata.gov.al/rrethi-elbasan/gjykata-e-shkall%C3%ABs-s%C3%AB-par%C3%AB-e-juridiksionit-t%C3%AB-pergjithsh%C3%ABm-elbasan/gjykata/rreth-gjykat%C3%ABs/<br><br>Faleminderit<br><br>**Manjola Kume**<br>**Koordinatore e të Drejtës së Informimit**<br>**Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Median**<br>E-mail: manjola.kume@gjykata.gov.al<br>Adresa: Lagjja "5 Maji", Rruga "Koço Brisku", Elbasan, Shqipëri<br>Telefon: 00355 54 25 99 51<br>Website: www.gjykataelbasan.gov.al<br>**Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan \| Elbasan First Instance Court of General Jurisdiction** | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 59 | 27.09.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues G.D.**<br><br>*Pershendetje!*<br><br>*Nepermjet sherbimit postar, kam kerkuar me date 17.09.2024 nga ana e Gjykates se Shkalles se Pare te Juridiksionit te Pergjithshem Elbasan, te me vendose ne dispozicion nje vertetim ne lidhje me te perfaqesuaren prej meje A.B.*<br><br>*Bashkelidhur kerkeses kam derguar pullen e takses per sherbimin e kerkuar, pullen e njoftimit per efekt te tarifes postare te kthimit te pergjigjes, prokuren noteriale si dhe dokumentin e identifikimit te te perfaqesuares prej meje A.B.*<br><br>*Sipas konfermes postare, kjo shkrese ka mberritur ne Institucionin tuaj me date 18.09.2024.*<br><br>*A eshte e mundur qe ky dokument te me dergohet ne rruge postare ne adresen time?*<br><br>*Me konsiderate,*<br><br>*Av. G.D.* | **Përgjigje 59.**<br><br>Përshëndetje,<br><br>Kërkesa është përcjellë në arkivë, më konfirmohet që është procesuar.<br><br>Ju lutem në kërkesa bashkëlidhni mjet identifikimi.<br><br>Faleminderit<br><br>**Manjola Kume**<br>**Koordinatore e të Drejtës së Informimit**<br>**Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Median**<br>E-mail: manjola.kume@gjykata.gov.al<br>Adresa: Lagjja "5 Maji", Rruga "Koço Brisku", Elbasan, Shqipëri<br>Telefon: 00355 54 25 99 51<br>Website: www.gjykataelbasan.gov.al<br>**Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan \| Elbasan First Instance Court of General Jurisdiction** | 30.09.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 60 | 30.09.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues B.T**<br><br>*Kërkesa me Nr. 25782 Prot., Kërkuesi B.T vuajtës i dënimit në një Ievp të Republikës së Shqipërisë kërkon nga Gjykata ndryshimin e identitetit.* | **Përgjigje 60.**<br><br>Në përgjigje të kërkesës suaj të depozituar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan më datë 30.09.2024 me objekt "Kërkesë", ju bëjmë me dije se në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të Drejtën e Informimit", kërkesa është regjistruar me Nr. 25782 Prot., datë 30.09.2024, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.<br>Ju informojmë se kërkesat me objekt "Ndryshim Emri" nuk shqyrtohen nga gjykata.<br><br>Për informacion të mëtejshmëm referohuni në nenet 57; 57/1 deri në 57/10 të Ligj Nr. 10 129, datë 11.5.2009 "Për Gjendjen Civile" (Ndryshuar me ligjet nr.6/2012, datë 2.2.2012, nr.130/2013, datë 25.4.2013, nr. 134/2016, datë 22.12.2016, nr. 69/2018, datë 11.10.2018 dhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 52, datë 1.12.2011) (i përditësuar).<br><br>Lutemi drejtoni kërkesën tuaj institucionit përgjegjës në përputhje me normat ligjore në fuqi.<br>Faleminderit<br><br>**GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN**<br>**KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT**<br>**Manjola Kume** | 04.10.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |
| 61 | 07.10.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues F.T.**<br><br>*Uroj te jeni mir.*<br>*Une F.T kam bere kerkes per te mare nji kopje te dosjes penale me vendim ne dt 24-06-2024.*<br>*Para pak minutash isha ne sekretarine e gjykates ne kat te pare dhe punojesja juaj me tha se dosja nuk u ka kopjuar sepse nuk ka fotokopje dhe me tha te vij pas 1 muaji.*<br>*Me duket pa vend nji arsyeje e tille.*<br>*Kerkoj nga ju ti ipni zgjidhje kesaj situate absurde.*<br>*Duke ju falenderuar per mirekuptimin dhe me respekt ndaj jush F.T.* | **Përgjigje 61**<br><br>Përshëndetje,<br><br>Në përgjigje të kërkesës suaj, kërkesat për kopje vendimesh, aktesh dhe dosje gjyqësore kryhen në Zyrën e Arkivës kati 3-të, pas plotësimit të formularit të kërkesës sipas objektit.<br><br>Depozitoni kërkesën tuaj, formularët e të cilës do t`i gjeni në sportel tek zyra e Arkivës, me objekt "Kopje të dosjes gjyqësore" me të dhënat përkatëse, ku bashkëlidhur kërkesës do t`iu kërkohet edhe mjet idetnifikimi dhe kontakt telefonik. | 07.10.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Plotësoni kërkesën tuaj si më sipër dhe pas përllogaritjes dhe pagesës së shpenzimeve gjyqësore për fotokopjim të akteve të dosjes, do të kontaktoheni nga nëpunësi përkatës për tërheqjen e akteve të dosjes në momentin e përfundimit të procesit të fotokopjimit.<br><br>Faleminderit<br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<br>Zyra Marrëdhënieve me Publikun dhe Median<br>Kontakt: manjola.kume@gjykata.gov.al | | | |
| 62 | 07.10.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues F.T.**<br><br>*Përshëndetje, nisur e nga biseda telefonike që pata para disa minutash me një përfaqësues të gjykatës së Elbasanit, po ju dërgoj Kërkesën time për Informacion.*<br><br>*Mua më quajnë T.L, jam gazetar i lirë e nuk punoj për ndonjë media (Frëlance Journalist), (me NR ID: J… të bashkangjitur me fotokopje karte identiteti në e-mailin tuaj) e po e kryej këtë kërkesë si individ duke u bazuar në Ligjin Nr. 119/2014, PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT, Neni 3, dëshiroj të di në lidhje me OJF-në "K………"*<br>*- NIPT-in e saj*<br>*- Administratori/ët*<br>*- Përshkrimin e OJF-së (çfarë misioni ka e qëllimesh)*<br>*- Vitin që është krijuar*<br><br>*Në dijeninë time kjo si OJF është krijuar nga personi B. G. dhe kërkoj t'a verifikoj.*<br><br>*Do të dëshiroja, ashtu siç e shpreh dhe Neni 3 i Ligjit për të drejtën për informim, kopje të dokumentave origjinal që janë dërguar tek ju për regjistrimin e kësaj OJF-je.*<br><br>*Në pritje të një përgjigjeje nga ju,*<br>*Me respekt,*<br>*T.L* | **Përgjigje 62.**<br><br>Përshëndetje,<br><br>Në përgjigje të kërkesës suaj të depozituar në adresën zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan manjola.kume@gjykata.gov.al më datë 07.10.2024 me objekt "Kërkesë për informacion", ju bëjmë me dije se në përputhje me Ligji nr.119/2014, "Për të Drejtën e Informimit", kërkesa juaj është shqyrtuar.<br><br>Ju informojmë se Organizatat Jofitimprurëse rregullohen me **Ligj Nr. 80/2021 "Për regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse"**, në të cilin neni Neni 6 i këtij ligji përcakton se *"Mënyra e regjistrimit 1. Regjistrimi fillestar dhe çdo regjistrim tjetër kryhet nëpërmjet paraqitjes së kërkesës për regjistrim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kërkesa për regjistrim paraqitet në formë shkresore ose në formë elektronike, sipas përcaktimeve të këtij ligji. 2. Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton formularët e kërkesave për regjistrim, si dhe listën e dokumenteve shoqëruese për çdo regjistrim që kryhet në regjistër sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. "*<br><br>Lutemi referohuni legjislacionit në fuqi dhe drejtoni kërkesën tuaj institucionit përkatës.<br><br>Faleminderit | 08.10.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | **Manjola Kume**<br>**Koordinatore e të Drejtës së Informimit**<br>**Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Median**<br>E-mail: manjola.kume@gjykata.gov.al<br>Adresa: Lagjja "5 Maji", Rruga "Koço Brisku", Elbasan, Shqipëri<br>Telefon: 00355 54 25 99 51<br>Website: www.gjykataelbasan.gov.al<br>**Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan \| Elbasan First Instance Court of General Jurisdictions** | | | |
| 63 | 24.09.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues D.H.,**<br><br>**Nr. 1591 Prot.,**<br><br>Në bazë të ligjit për të drejtën e informimit kërkoj nga Klgj:<br><br>1. Sa martesa nën 18 vjeç kanë lejuar gjykatat e vendit në vitet 2021,2022, 2023. Po ketët vit nga Janari ne Gusht? (të ndara në vite.<br>2. Cilat qytete kkanë nr më të lartë.<br>3. Cilave komuniteti i përkasin.<br>4. Cilat janë shkaqet kryesore. | **Përgjigje 63.**<br><br>**Përgjigjja bashkëlidhur,**<br><br>Përshëndetje znj D.H.,<br><br>Bashkëlidhur gjendet kthim përgjigje Nr. ….. Prot., për kërkesën drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor në lidhje me kërkesat me objekt "Lejim Martese"<br><br>Faleminderit<br><br>**Manjola Kume**<br>**Koordinatore e të Drejtës së Informimit**<br>**Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Median**<br>E-mail: manjola.kume@gjykata.gov.al<br>Adresa: Lagjja "5 Maji", Rruga "Koço Brisku", Elbasan, Shqipëri<br>Telefon: 00355 54 25 99 51<br>Website: www.gjykataelbasan.gov.al<br>**Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan \| Elbasan First Instance Court of General Jurisdiction**<br><br>**Bashkëlidhja**<br><br>Shprehim konsideratën tonë për veprimtarinë tuaj, në përgjigje të kërkesës suaj të depozituar në Gjykatën e Shkalles së Parë te Juridiksionit të Pergjithshëm Elbasan më datë 24.09.2024 me objekt "Kërkesë për Informacion ", drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor në kontaktin e postës | 09.10.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | elektrenike kontakt.kisi@klgj.al. Ju informojmë se shkresa me Nr. ………. Prot., e Keshillit te Lartẽ Giyqësor ne perputhje me nenin 11 te Ligjit nr.119/2014, ""Per të Drejtën e Informimit' kërkesa është regjistruar me Nr. ….Prot., datë 24.09.2024, në Gjykatën e Shkallës së Parë te Juridiksionit të Pergjithshëm Eibasan.<br><br>Kërkesa u delegua për shqyrtim më date 09.10.2024 tek koordinatori për te drejtën e informimit.<br><br>Nga kontrolli ushtruar rezulton:<br>-Në lidhje me kërkesat me objekt " Lejim Martese" për vitet 2017-2018, nga kontroili ushtruar në Sisternin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Shkalles së Parë e Juridiksionit te Pergjithshëm Elbasan rezulton 1 (një) regjstrim kẽrkese me objekt " Lejim Martese"<br><br>-Në lidhje me kërkesat me objekt "Lejim Martese" nga viti 2019-2024, nga kontrolli ushtruar ne Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Shkalles së Parë e Juridiksionit te P3rgjithshëm Elbasan nuk rezultojnë registrime sipas këtij objekti.<br><br>Faleminderit<br><br>**Manjola Kume**<br>**Koordinatore e të Drejtës së Informimit**<br>**Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Median** | | | |
| 64 | 24.09.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues**<br><br>*Pershendetje Znj. Kume,*<br><br>*Uroj qe ky email t'ju gjeje mire!*<br><br>*FONDACIONI SHQIPTAR PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFËSI TË KUFIZUARA (FSHDPAK) është një organizatë shqiptare jofitimprurëse, themeluar nga OXFAM GB në vitin 1996. Programet e FSHDPAK, synojnë të rrisin shanset e personave me aftësi të kufizuara për t'u integruar në jetën sociale, ekonomike, politike e kulturore te vendit, përmes respektimit dhe mbrojtjes të të drejtave të tyre. Që nga krijimi, FSHDPAK ka funksionuar si qendër koordinimi për ndërmarrjen e nismave më madhore me ndikim në* | **Përgjigje 64**<br><br>*03.10.2024*<br><br>Përshëndetje znj. C,<br><br>Në përgjigje të kërkesës suaj të depozituar në adresën zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan manjola.kume@gjykata.gov.al më datë 24.09.2024 me objekt "Kërkesë për informacion", ju bëjmë me dije se në përputhje me Ligji nr.119/2014, "Për të Drejtën e Informimit", kërkesa juaj është në proces shqyrtimi pasiqë të dhënat e kërkuara nuk janë të pasqyrauar në formën e kërkuar | 14.10.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *përmirësimin e cilësisë së jetës për personat me aftësi të kufizuara në Shqipëri. Për të përmbushur misionin tonë, ne punojmë së bashku me dhe pa aftësi te kufizuara.*<br><br>*FSHDPAK së bashku me Shoqatën Kombëtare Shqiptare të Njerëzve që nuk Dëgjojnë (ANAD), Fondacionin Down Syndrome Albania (DSA) ka filluar zbatimin e projektit "Qasje gjithëpërfshirëse për të garantuar akses të barabartë në drejtësi për personat me aftësi të kufizuara në Shqipëri", financuar nga Bashkimi Evropian.*<br><br>*Në kuadër të këtij projekti do të realizohet një udhëzues/raport monitorimi gjithëpërfshirës mbi njohjen e barabartë para ligjit dhe aksesin në drejtësi, duke përfshirë aksesin në ndihmë juridike falas për personat me aftësi të kufizuar në Shqipëri, përputhjen e legjislacionit me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK) dhe standardeve më të mira të BE-së.*<br><br>*Do e vlerësonim shumë kontributin tuaj në mbledhjen e të dhënave cilësore dhe sasiore për institucionin që përfaqësoni për aksesin e personave me aftësi të kufizuar në sistemin e drejtësisë,.*<br><br>*Lutemi nëse keni mundësi na dërgoni pyetësrin e plotësuar brenda dates 3 Tetor.*<br><br>*Me respekt,*<br><br>*B.C.*<br>*Drejtore Ekzekutive*<br><br>*Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me afësi të kufizuara* | në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, kërkesa i është përcjellë për evidetnim zyrës së përpunimit të statistikave gjithashtu.<br><br>Në ditët në vijim do t`iu vendosim në dispozicion përmbledhje të informacionit të kërkuar sipas objektit të kërkesës.<br><br>Faleminderit<br><br>**Manjola Kume**<br>**Koordinatore e të Drejtës së Informimit**<br>**Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Median**<br>E-mail: manjola.kume@gjykata.gov.al<br>Adresa: Lagjja "5 Maji", Rruga "Koço Brisku", Elbasan, Shqipëri<br>Telefon: 00355 54 25 99 51<br>Website: www.gjykataelbasan.gov.al<br>**Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan \| Elbasan First Instance Court of General Jurisdiction**<br><br>**Përgjigje 64/1**<br><br>*14.10.2024*<br><br>Përshëndetje znj. B.C,<br><br>Në përgjigje të kërkesës suaj të depozituar në adresën zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ju dërgojmë bashkëlidhur kthim përgjigje të cilën mund ta përshtasni sipas nevojave tuaja në formular.<br><br>Për çdo paqartësi mund të na kontaktoni.<br><br>Faleminderit<br><br>**Manjola Kume**<br>**Koordinatore e të Drejtës së Informimit**<br>**Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Median**<br>E-mail: manjola.kume@gjykata.gov.al | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Adresa: Lagjja “5 Maji”, Rruga “Koço Brisku”, Elbasan, Shqipëri<br>Telefon: 00355 54 25 99 51<br>Website: www.gjykataelbasan.gov.al<br>**Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan \| Elbasan First Instance Court of General Jurisdiction**<br><br>**Përgjigjja në bashkëlidhje.**<br><br>Duke shprehur konsideratën tonë për veprimtarinë tuaj, në përgjigje të kërkesës suaj të depozituar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan më datë 02.10.2024 me objekt “Kërkesë për informacion për personat me aftësi të kufizuar”, me Nr. ....... Prot., ju bëjmë me dije se në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, “Për të Drejtën e Informimit”, kërkesa është regjistruar me Nr. 1……. Prot., datë 02.10.2024, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Ju informojmë se kërkesa është depozituar edhe në postën elektronike të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për të cilën ju kemi kthyer përgjigje nga posta elektronike më datë 03.10.2024 për t`iu njoftuar që kërkesa juaj është marrë në shqyrtim dhe është në proces përpunimi. Një kopje e kthim përgjigjes do të dërgohet edhe nëpërmjet postës elektronike sipas kërkesës së depozituar.<br><br>Ju informojmë se në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan është rritur angazhimi dhe asistenca për personat me aftësi të kufizuar, gjykata ka përcaktuar një ambient të posaçëm për qëndrimin, publikimin e të drejtave dhe garancive të personave me aftësi të kufizuar.<br><br>Gjykata ka siguruar akses fizik nëpërmjet rampave të personave me aftësi të kufizuar në lëvizje, në sallat e gjyqit. Për vitin 2022-2024, ky akses fizik garantohet për të 10 sallat e gjykimit dhe hyrjet në gjykatë. Gjithashtu gjykata ka pajisur mjediset e aksesit publik.<br><br>Kryesekretaria dhe sallat e gjykimit janë të pajisura me tregues për personat me shikim të kufizuar. Sfidë për të ardhmen mbetet sigurimi i asistencës së specializuar për interprete etj., nga | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | organizata joqeveritare për personat me aftësi të kufizuar që marrin pjesë në procese apo marrin shërbim në gjykatë.<br><br>Është bërë e mundur funksionimi i videokonferencës për zhvillimin e seancave pa praninë fizike të personave, duke përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuar si dhe konsultimin online  të dosjeve gjyqësore.  Institucioni gjithashtu është i pajisur me ashensor.<br><br>Në periudhën 2022-2024 në kërkesat e paraqitura nëpërmjet e-mail të postës elektronike të gjykatës, nuk rezultojnë kërkesa për vënie në dispozicion të vendimit të gjykatës në format Braill, gjithashtu nuk rezultojnë kërkesa të depozituara në protokoll me këtë objekt.<br><br>Nga të dhënat e Zyrës së Buxhetit nuk rezultojnë  të dhëna shpenzimesh të kryera,  për kërkesa të palëve për nevoja të interpretit të gjuhës së shenjave apo sistemit të shkrimit Braille.<br><br>Nevoja për interpret të gjuhës së shenjave është edhe e vetë gjykatës, për interpretim të videove që duhet të vendosim në dispozicion të informimit të publikut edhe për kategorinë e personave me aftësi të kufizuar, në kuadër të plotësimit të objektivave të Planit Strategjik të Komunikimit, miratuar me vendimin nr. 590 datë 26.11.2020 nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.<br><br>Gjatë vitit 2023 dhe 2024, në kuadër të sensibilizimit të të rinjve në lidhje me aftësinë e kufizuar dhe të drejtat e fëmijëve, janë organizuar takime dhe janë angazhuar një numër i konsiderueshëm nxënësish, në bashkëpunim edhe me institucionet arsimore, duke i ofruar informacion mbi legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar në lidhje me të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuar.<br><br>Në vitin 2024 temë specifike për trajtim dhe sensibilizim u përcaktua “Inkluzioni dhe informimi mbi të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuar”, duke përshtatur informacionin mbi Deklaratën Salamanca 1994 dhe ligje kombëtare dhe ndërkombëtare me këtë objekt. Këtë informacion u angazhuam që të riprodhohej nga nxënësit në formën e një eseje në lidhje me këtë tematikë, esetë e të cilëve janë bërë publike në rrejtet sociale dhe në faqen zyrtare të gjykatës. | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Nuk rezulton të jenë kryer trajnime të stafit të administratës për çështjë të aftësisë së kufizuar për vitet 2022-2024.<br><br>Në gjykatë ka akses çdo palë në proces për pajisjen me kopje të regjistrimit audio të seancës pa përcaktime e kritere të veçanta për marrrjen e saj. Për marrjen e kopjes të CD mjafton të depozitohet një kërkesës me objekt "Pajisje me kopje të regjistrimit audio" dhe pagesa e shpenzimeve gjyqësore.<br><br>Identifikimi i palëve në proces gjyqësor, mënyra e përfaqësimit të palëve gjendet në aktet e dosjeve gjyqësore sipas objekteve të kërkesë padive të depozituara, për të cilat gjykata në fund të procesit shprehet me vendimmarrje, e cila sërisht bëhet pjesë e fashikullit të dosjes gjyqësore, por nuk rezultojnë statistika të detajuara me këtë objekt.<br><br>Në lidhje me shoqërimin e personave me aftësi të kufizuar, vihet re që kryesisht shoqërohen nga të afërmit dhe kujdestarët ligjorë. Informacionet që ofrohen në faqen zyrtare online të gjykatës janë kryesisht të orientuara në formë broshurarsh për dhënien e informacionit mbi legjislacionin për personat me aftësi të kufizuar. Për orientimin në gjykatë është realizuar video me zë por pa interpret të gjuhës së shenjave.<br><br>Në faqen zyrtare në rubrikën Njoftime për Publikun dhe rrjetet sociale në datë 20.04.2023 është publikuar në format broshure informacion me titull "Fletëpalosje informuese për personat me aftësi të kufizuar", gjithashtu edhe në datë 04.08.2023 është publikuar informacion në format broshure me titull "Personat me aftësi të kufizuar kuadri ligjor i garantimit të të drejtave të tyre në Shqipëri".<br><br>Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka një zë në buxhet për të paguar përkthyesit e gjuhës së huaj, si edhe interpretët e gjuhës së shenjave. Buxheti i përdorur për vitet 2022-2023 është 0 all. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan nuk ka patur proces penal me të pandehur persona me aftësi të kufizuar në dëgjim dhe në të folur.<br><br>Përzgjedhja e interpretëve të gjuhës së shenjave bëhet nga lista e ekspertëve të liçensuar në faqen zyrtare të Ministrisë së | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Drejtësisë. Gjykatat janë përgjegjëse për të paguar interpretët e gjuhës së shenjave vetëm për çështjet që janë në gjykim, për të cilat shprehen trupat gjyqësore me vërtetim gjyqësor.<br><br>Për vitet 2022-2023 nuk ka patur refuzim nga interpretët e gjuhës së shenjave për të marrë pjesë në një proces penal.<br><br>Sipas të dhënave të gjenerauara nga Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqëosre, rezulton se për çështjet me objekt "Heqje/ kufizim i zotësisë për të vepruar dhe caktim kujdestarie" janë regjistruar:<br><br>**Në vitin 2022,** janë regjistruar 4 (katër) **kërkesa të reja** me këtë objekt, ndër të cilat 2 janë në përpunim.<br><br>**Në vitin 2022**, në regjistrin manual rezulton të jenë caktuar 9 ( nëntë) kujdestarë me vendimmarrje.<br><br>**Në vitin 2023,** janë regjistruar 2 (dy) kërkesa me këtë objekt, (1) një kërkesë rezulton me vendimmarrje dhe 1 (një) kërkesë rezutlon në përpunim.<br><br>**Në vitin 2023,** në regjistrin manual rezulton 1 (një) vendimmarrje me caktimi kujdestarie.<br><br>**Në vitin 2022**, është regjistruar 1 (një) kërkesë civile e veçantë me bazë ligjore Ligj nr. 44/2012 "Për Shëndetin Mendor", me objekt kërkese "Revokim vendimi për velerësim të masës për shtrim dhe trajtim të pavullnetshëm të personave me çrregullime të shëndetit mendor" e cila është pranuar.<br><br>**Në vitin 2022**, është regjistruar 1 (një) kërkesë civile e veçantë me bazë ligjore Ligj nr. 44/2012 "Për Shëndetin Mendor", me objekt kërkese "Revokim vendimi për velerësim të masës për shtrim dhe trajtim të pavullnetshëm të personave me çrregullime të shëndetit mendor" e cila është pranuar.<br><br>**Në vitin 2023**, nuk rezultojnë regjistrime për kërkesat civile të veçanta me bazë ligjore Ligj nr. 44/2012 "Për Shëndetin Mendor", me objekt kërkese "Shtrim dhe trajtim të pavullnetshëm të personave me çrregullime të shëndetit mendor". | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | **Në vitin 2023**, nuk rezultojnë regjistrime për kërkesat civile të vecanta me bazë ligjore Ligj nr. 44/2012 "Për Shëndetin Mendor", me objekt kërkese "Revokim vendimi për velerësim të masës për shtrim dhe trajtim të pavullnetshëm të personave me çrregullime të shëndetit mendor".<br><br>Referuar kodit penal Neni 46 "Masat mjekësore dhe edukuese. *''Masat mjekësore mund të jepen nga gjykata ndaj personave të papërgjegjshëm që kanë kryer vepër penale, ndërsa masat edukuese mund të jepen ndaj të miturve që përjashtohen nga dënimi ose që për shkak të moshës nuk kanë përgjegjësi penale. Masat mjekësore janë:*<br>1. *Mjekimi i detyruar ambulator*<br>2. *Mjekimi i detyruar në një institucion mjekësor*<br>*Vendimi gjyqësor për masat mjekësore dhe edukuese është i revokueshëm në çdo kohë kur zhduken rrethanat për të cilat ai është dhënë, por në çdo rast, gjykata, kryesisht, është e detyruar që pas kalimit të një viti nga dita e dhënies së vendimit, të marrë në shqyrtim vendimin e saj.*<br>*Rregullat për revokimin e vendimit gjyqësor që përmbajnë masa mjekësore parashikohen në Kodin e Procedurës Penale. Rregullat për caktimin ose revokimin e masave mjekësore dhe edukuese për të miturin parashikohen nga Kodi i Drejtësisë për të Mitur''.*<br><br>**Në vitin 2022,** janë regjistruar 10 (dhjetë) kërkesa për pushim çështje dhe caktim mase mjekësore, ndër të cilat 9 (nëntë) kanë vendimmarrje dhe 1 (një) është në përpunim. Ndër to kemi 1 (një) vendimmarrje me kthim aktesh dhe 1 (një) vendimmarrje pushim, 7 (shtatë) vendimmarrje janë pranim i kërkesës për caktim mase mjekësore.<br><br>**Për vitin 2023,** janë regjistruar 2 (dy) kërkesa për pushim çështje dhe caktim mase mjekësore, ndër të cilat 1 (një) rezulton me vendimmarrje pranim kërkese për pushim dhe caktim mase mjekësore dhe 1 (një) çështje rezulton ende në përpunim.<br><br>Mbetemi në gadishmërinë tuaj për çdo paqartësi dhe jemi të hapur për bashkëpunim si dhe krijimin e kontakteve ndërinstitucionale për trajtimin e vështirësive, problematikave, organizimin dhe strukturimin e materialeve informuese, | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | shkëmbimin apo krijimin e një database me kontaktet e personave të specializuar dhe të licensuar për interpretë të gjuhës së shenjave dhe njohësit e sistemit të të shkruarit Braille.<br><br>Me konsideratë,<br><br>**GJYKATA E SHKALLËS SË PARË**<br>**E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN**<br>**KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT**<br>**Manjola Kume** | | | |
| 65 | 30.10.2024 | **Ankesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues E.B.,**<br><br>*Nr. ………..Prot.,*<br><br>*Avokati E.B ka paraqitur ankim mbi vonesën e gjykimit të çështjes të cilën përfaqëson me znj. E.LL.* | **Përgjigje 65.**<br><br>Në përgjigje të kërkesës suaj të depozituar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan më datë 30.10.2024 me objekt "Kërkesë", ju bëjmë me dije se në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të Drejtën e Informimit", kërkesa është regjistruar me Nr. ……. Prot., datë 30.10.2024 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.<br>Fillimisht shprehim konsideratën tonë për punën tuaj i nderuar avokat, z. E.B.<br>Ju informojmë se kërkesa është shqyrtuar.<br>Nga kontrolli ushtruar në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore rezulton se, çështja me palë në proces gjyqësor ………….. me ……… është regjistruar në 18.01.2024 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, e shortuar me gjyqtare znj. ……… me të cilën janë zhvilluar 4 (katër) seanca përgatitore, e fundit është zhvilluar më datë 23.05.2024.<br>Për shkak të transferimit të gjyqtares znj. ……….. për ushtrimin e funksionit të saj në një gjykatë tjetër të Republikës së Shqipërisë, çështja është rishortuar me short elektronik me gjyqtare tjetër që ushtron funksionin në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan znj. …………më datë 26.06.2024.<br><br>Shprehim keqardhjen tonë për konstatimin tuaj në këtë kërkesë si **mospërfillje**, duke ju informuar se, gjyqtarët e Gjykatës së Shkalës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan kanë në | 04.11.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | shqyrtim një numër të lartë çështjesh për gjykim të mbartura për shkak të shkarkimeve nga vetting-u, apo transferimeve të herëpashershme të gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan në gjykata të tjera të Republikës së Shqipërisë, me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor.<br><br>Çështjet e mbartura janë shpërndarë ndërmjet gjyqtarëve që aktualisht ushtrojnë funksionin në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, me short elektronik fillestar ose si rishortim të çështjeve, për shkak të transferimeve dhe ndryshimeve të sipër cituara të gjyqtarëve.<br><br>Gjyqtarët që aktualisht ushtrojnë funksionin e tyre në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, janë duke punuar me një intensitet të lartë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura, përpos shqyrtimve të çështjeve të ardhura të reja, numri i të cilave është konsiderueshëm i lartë.<br><br>Në kuadër të transparencës dhe llogaridhënies palët, avokatët dhe publiku i interesuar janë njoftuar me njoftim publik se, shqyrtimi i çështjeve gjyqësore dhe vendosja e tyre në lëvizje në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për sa lidhet me çështjet e prapambetura, do të kryhet në përputhje me metodologjinë që do të përcaktohet *duke mbajtur në konsideratë se,*<br><br>• Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar aktin "*Strategjia Kombëtare e Uljes së Numrit të Çështjeve të Prapambetura në Gjykata (2024-2027)*".<br>• Me Vendimin nr. 252, datë 09.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është vendosur: "*Miratimi i raportit vlerësues të grupit të punës për hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata për rritjen e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë*".<br>• Në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 78, datë 30.05.2019 "Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit", të ndryshuar me Vendimin nr. 254, datë 09.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 78, | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | datë 30.05.2019 "Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit", në Kreun I, pika 1 parashikohet se: "*Caktimi i datës dhe orës së gjykimit të çështjes së ardhur mbi ankim të palës/palëve, bëhet nga gjyqtari relator, në përputhje me kalendarin e tij të shqyrtimit të çështjeve, duke marrë për bazë radhën, <u>sipas kohës së ardhjes së dosjes në gjykatën e apelit ose listën e grupçështjeve të caktuara në përjashtim të radhës sipas vendimit të Këshillit të Gjykatës</u>*".<br><br>• Në Kreun I, në pikën 1/1 të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 78, datë 30.05.2019 "Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit", të ndryshuar, parashikohet se: "*1/1 Listat e shqyrtimit të grupçështjeve të caktuara në përjashtim të rregullit të shqyrtimit sipas kohës së regjistrimit të tyre, me qëllim përmirësimin e shpejtësisë dhe të efektivitetit të gjykimeve dhe uljes së çështjeve të prapambetura, <u>hartohen nga Këshilli i Gjykatës pasi të jetë marrë mendimi i mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve,</u> sipas rregullave të përcaktuara në këtë vendim.*"<br>• Në Kreun IV, pika 4 parashikohet se: "*Në përfundim të procesit të analizimit dhe klasifikimit të çështjeve të prapambetura, Këshilli i Gjykatës merr masa për krijimin e listave të grupçështjeve sipas pikës 1.1 të këtij vendimi dhe ia përcjell ato menjëherë gjyqtarëve (...)*".<br>*ulton se,*<br><br>Mbledhjen e Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, datë 15.10.2024 është marrë mendimi i trupës gjyqësore për sa më sipër.<br><br>**Vendimin nr. 1796 prot., datë 21.10.2024 të Këshillit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan është vendosur: *"(…) 2. Kategorizimi dhe inventarizimi i çështjeve gjyqësore të prapambetura dhe marrja e masave në vijim me qëllim uljen e numrit të çështjeve gjyqësore të prapambetura (…)"*.**<br>*këto kushte,* | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | zbatim të këtyre akteve dhe vendimeve, informohen palët në proceset gjyqësore, avokatët si dhe publiku i interesuar se Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan:<br><br>• ***Po analizon përcaktimin e një metodologjie objektive për të kategorizuar dhe inventarizuar listat e grupçështjeve të prapambetura që do të vendosen në lëvizje me procedura të përshpejtuara.***<br><br>kuadër të parimit të transparencës dhe llogaridhënies së gjyqësorit, krijimi i grupçështjeve që do të shqyrtohen duke u vendosur në lëvizje me procedura të përshpejtuara, pas marrjes së mendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve dhe vendimmarrjes së Këshillit të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, do të komunikohet për palët dhe publikun.<br><br>*Në përfundim ju informojmë se,*<br><br>Një kopje e kërkesës tuaj dhe përgjigjes do të depozitohet në Arkivën e Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe një kopje në dosjen gjyqësore të çështjes ...........<br><br>Planifikimet e seancave gjyqësore për çështjen do të kryhen nëpërmjet akteve njoftuese sipas procedurave ligjore në fuqi.<br><br>Faleminderit,<br><br>**GJYKATA E SHKALLËS SË PARË<br>E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN**<br><br>**KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT<br>Manjola Kume** | | | |
| 66 | 11.10.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues S.O.**<br><br>*Gjykata Elbasan*<br><br>*Unë, S.O., student i drejtësisë në Universitetin A, Xhuvani , ju drejtohem me këtë kërkesë për të marrë pjesë në seancat gjyqësore që zhvillohen në gjykatën tuaj. Si pjesë e programit tim akademik, është e domosdoshme të ndjek seancat* | **Përgjigje 66.**<br><br>Përshëndetje!<br><br>Seancat gjyqësore me dyer të hapura mund të ndiqen nga publiku me letërnjoftim dhe me miratim të gjyqtarit të seancës në varësi të kuotave. | | I plotë | Nuk ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *gjyqësore për të përvetësuar njohuritë praktike dhe për të kuptuar më mirë proceset juridike në praktikë.*<br><br>*Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij aspekti për formimin tim profesional, do të isha shumë mirënjohës nëse do të mund të më jepet mundësia të ndjek seancat gjyqësore. Premtoj të respektoj të gjitha rregullat dhe protokollet e gjykatës gjatë pjesëmarrjes sime.*<br><br>*Ju falënderoj paraprakisht për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.*<br><br>*Me respekt*<br>*S.O.*<br>*S..................................@............Com* | Mund të paraqiteni në gjykatë.<br><br>Faleminderit<br><br>**Manjola Kume**<br>**Koordinatore e të Drejtës së Informimit**<br>**Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Median**<br>E-mail: manjola.kume@gjykata.gov.al<br>Adresa: Lagjja "5 Maji", Rruga "Koço Brisku", Elbasan, Shqipëri<br>Telefon: 00355 54 25 99 51<br>Website: www.gjykataelbasan.gov.al<br>**Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan \| Elbasan First Instance Court of General Jurisdiction** | | | |
| 67 | | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues B.N.(Media)**<br><br>Mon 10/14/2024, 3:38 PM<br><br>*Informacion për çështjen ……Shteti kundër M.Z., S.T., dhe F.A.,* | **Përgjigje 67**<br><br>Përshëndetje,<br><br>Në përgjigje të kërkesës suaj të depozituar në adresën zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan manjola.kume@gjykata.gov.al më datë 14.10.2024 me objekt "Kërkesë për pjesëmarrje në seancë gjyqësore", ju bëjmë me dije se në përputhje me Ligji nr.119/2014, "Për të Drejtën e Informimit", kërkesa juaj është shqyrtuar dhe nga kërkimi në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore rezulton se çështja me palë M.K., .S. T., dhe F.D., është kërkesë penale në fazën e shqyrtimit në seancë paraprake.<br><br>Referuar bazës ligjore neni 332/b/1 të Kodit të Procedurës Penale: "*Verifikimi i paraqitjes së palëve 1. Seanca zhvillohet me dyer të mbyllura, me pjesëmarrjen e domosdoshme të prokurorit dhe mbrojtësit të të pandehurit."*<br><br>Nuk lejohet prania e mediave dhe publikut.<br><br>Faleminderit<br><br>**Manjola Kume** | 14.10.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | **Koordinatore e të Drejtës së Informimit**<br>**Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Median**<br>E-mail: manjola.kume@gjykata.gov.al<br>Adresa: Lagjja "5 Maji", Rruga "Koço Brisku", Elbasan, Shqipëri<br>Telefon: 00355 54 25 99 51<br>Website: www.gjykataelbasan.gov.al | | | |
| 68 | 15.10.2024 | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues A. M.,**<br><br>*Miredita ju pershendes, quhem A.M, une kam nje Problem me vajzen time, H.H., ka qe nje vit qe ka nisur gjyqi per ndarje , nuk kam idene perse nuk ka filluar, e para e dyta dt e fundit e pati me dt 5 .10.2024 , nuk u zhvillua arsyea ishte se avokati i tij nuk paska dhene prokuren, ne fillim e pati tani thote nuk e kam, ju lutem si Sekretariat apo zevendes te kryetarit, ta shikoni, vajza ka shpallur ndarjen nga ish burri dhe nuk ka kthim, une ndodhem larg, si mundet te gjejme nje zgjidhje, me respektin me te madh, per ju,* | **Përgjigje 68.**<br><br>Përshëndetje,<br><br>Kërkesat për informacion mbi çështjet në gjykim dërgohen nga palët në proces gjyqësor ose përfaqësuesit ligjor të tyre duke u identifikuar.<br><br>Vendimet dhe njoftimet për seancat gjyqësore i përcillen palëve dhe përfaqësuesve ligjor sipas procedurave ligjore në fuqi të gjykatës.<br><br>Faleminderit<br><br>**Manjola Kume**<br>**Koordinatore e të Drejtës së Informimit**<br>**Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Median**<br>E-mail: manjola.kume@gjykata.gov.al<br>Adresa: Lagjja "5 Maji", Rruga "Koço Brisku", Elbasan, Shqipëri<br>Telefon: 00355 54 25 99 51<br>Website: www.gjykataelbasan.gov.al<br>**Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan \| Elbasan First Instance Court of General Jurisdiction** | 15.10.2024 | I plotë | Nuk ka tarifë |
| 69 | | **Kërkesë në lidhje me objektin si në vijim, kërkues B.N., (MEDIA)**<br><br>1. *Numri i denoncimeve per konflikte, dhune, shantazhe, ngacmime, përdorim te dhënash, shfrytëzim te te miturve, bullizim online per tri vitet e fundit*nëse nuk disponohet atëherë per nje vit* | **Përgjigje 69.**<br><br>*14.10.2024*<br><br>Përshëndetje,<br><br>Në përgjigje të kërkesës suaj të depozituar në adresën zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan manjola.kume@gjykata.gov.al më datë 20.09.2024 me | | I plotë | Nuk ka tarifë |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2. *Statistika vjetore te krimeve ndaj te miturive dhe nga te miturit per vitin 2023 ne qarkun e Elbasanit*<br>3. *Fluksi per gjyqtar i dosjeve per shkak te vetingut*<br>*Cilat janë vështirësitë qe hasin qytetaret per shkak te vakancave te krijuara nga vetingu* | objekt "Kërkesë për intervistë", për të cilën keni patur edhe komunikim telefonik me koordinatorin, ju bëjmë me dije se në përputhje me Ligji nr.119/2014, "Për të Drejtën e Informimit", kërkesa juaj është shqyrtuar dhe është konfirmuar data e takimit për realizimin e intervistës data **…….** ora **…….**<br><br>Intervista do të zhvillohet në ambientet e Gjykatës së **Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan** nga gjyqtari i Seksionit Penal **z. Elis Dine.**<br><br>Mbetemi në kontakt,<br><br>Faleminderit që na kontaktuat,<br><br>Manjola Kume<br><br>**Koordinatore e të Drejtës së Informimit**<br>**Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Median**<br>E-mail: manjola.kume@gjykata.gov.al<br>Adresa: Lagjja "5 Maji", Rruga "Koço Brisku", Elbasan, Shqipëri<br>Telefon: 00355 54 25 99 51<br>Website: www.gjykataelbasan.gov.al<br>**Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan \| Elbasan First Instance Court of General Jurisdiction**<br><br>(Kërkuesi është njoftuar paraparkisht brenda afateve për trajtimin e kërkesës nëpërmjet intervistës sipas interest të shprehur)<br><br>**Përgjigje 69/1**<br><br>*17.10.2024*<br><br>Përshëndetje,<br><br>Në vijim të intervistës së realizuar, ju bashkëlidhim raporte statistikash të përpunuara.<br><br>Faleminderit | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Manjola Kume<br><br>**Koordinatore e të Drejtës së Informimit**<br>**Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Median**<br>E-mail: manjola.kume@gjykata.gov.al<br>Adresa: Lagjja “5 Maji”, Rruga “Koço Brisku”, Elbasan, Shqipëri<br>Telefon: 00355 54 25 99 51<br>Website: www.gjykataelbasan.gov.al<br>**Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan \| Elbasan First Instance Court of General Jurisdiction**<br><br>***INFORMACION NË BASHKELLIDHJE 1***<br><br>**DHUNA NË FAMILJE DHE URDHËRA TË MËNJËHERSHËM MBROJTJE PËR VITIN 2022**<br><br>Statistikat për vitin 2022-2023, për kërkesat me objekt nenin 130/a "Dhuna në familje" dhe ligj Nr.9669, neni 10 dhe 13, “Urdhëra mbrojtje” në Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me të dhënat si në vijim.<br><br>**Numri i çështjeve me objekt nenin 130/a. "Dhuna në familje" , për vitin 2022 nga përpunimi i të dhënave rezulton se janë regjistruar:**<br><br>- 251 çështje,<br><br>- 28 prej të cilëve janë zbatuar "Urdhra të Menjëhershëm Mbrojtje".<br><br>**Lidhja me familjarët në dhunën në familje shpërndahet si më poshtë:**<br><br>- 187 raste të regjistruara nga dhuna e ushtruar nga bashkëshorti;<br><br>- 12 raste të regjistruara nga dhuna e ushtruar nga vëllai;<br><br>- 8 raste të regjistruara nga dhuna e ushtruar nga fëmija;<br><br>- 17 raste të regjistruara nga dhuna e ushtruar nga prindi;<br><br>- 27 raste të regjistruara nga dhuna e ushtruar nga të tjerë.<br><br>**Në zbatim të ligj Nr.9669, neni 10 dhe 13, për vitin 2022:** | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | - janë pranuar 131 këkresa për urdhëra mbrojtje;<br>- janë rrëzuar 64 këkresa për urdhëra mbrojtje;<br>- janë pushuar 56 çështje për urdhëra mbrojtje.<br>Referuar statistikave të vitit 2022, nga shpërndarja e rasteve referuar vendbanimit rezulton se:<br>- 111 prej tyre janë me vendbanim në qytet<br>- 41 në periferi<br>- 99 në fshat<br>Për sa i përket moshës, shtrirjen më të lartë e ka target grupi i moshës 19-55+ vjeç.<br>Për sa i përket gjinisë, numrin më të lartë e mban gjinia femërore me 211 çështje me subjekt dhuna në familje dhe vetëm 40 çështje gjinia mashkullore.<br>Në lidhje me statusin civil, numrin më të lartë e mban kategoria me status civil të martuar me 184 raste të regjistruara.<br>Për sa i përket nivelit arsimor, numrin më të lartë të kërkesave të regjistruara e mbajnë individët me nivel arsimor 9- vjeçar me 139 kërkesa dhe me nivel arsimor të mesëm 84 kërkesa.<br>Nuk mungojnë dhe rastet me nivel arsimor të lartë në të cilin për vitin 2022 regjistrohen 12 kërkesa.<br>**Përsa i përket statusit të punësimit, numrin më të lartë e mbajnë:**<br>- I vetëpunësuar me 88 kërkesa;<br>- Të papunët me 67 kërkesa;<br>- Pensionistët me 25 kërkesa;<br>**Për sa i përket formës së subjektit që depoziton kërkesën rezulton se për vitin 2022 kemi:**<br>- 3 kërkesa të depozituara nga përfaqësues ligjor;<br>- 2 me kërkesë nga prokuroria;<br>- 243 me kërkesë nga policia;<br>- 3 me kërkesë nga qendra sociale. | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
